

*L. Abdyl Kajanaku
Shk. Zgjeri*

VITI i III — MAJ-QERSHUER 1931 — Nr. 3-4

NORMALISTI

Jo në dijën, por në
vullnetin e fortë
qëndron vlera
e njeriut.

HERBART.

Drejtimi:
E përkohëshmeja "NORMALISTI",
Shkolla Normale
Elbasan.

Shtypshkronja "SAIDE", Elbasan
1931

M b r e n d i j a

Mbarimi i jetës shkollore për rendin '31	Faqe	1
Ata qi mbaruen Shkollën	"	4
Historia e rendit '31	"	5
Cili është rendi '31	"	7
Edukata e fëmijëve	"	13
Provë mësimi në rendin e III të	"	15
Provë mësimi në rendin e I të	"	17
Provë mësimi në rendin e II të	"	18
Provë mësimi në rendin e III të	"	20
Novelë — Nder vorre	"	22
Dita e Verës në Lumë	"	27
Vjerrsha për readin e parë të filllores	"	30
Hartim-Emni i atyne, qi punuen për atdhe ka mbetun i pavdekun	"	32
Vjerrshë — Prindët	"	35
Përkthim — Një ngjarje kusarësh	"	35
Përkthim — Çerdhja e zogjvet	"	38
Gojdhinë — Dibranët janë Mirditas	"	39
Folklorë	"	42
Për t' u-çlodhur	"	44
Problemë	"	44
Lajme të Shkollës	"	45
Posta e jonë	"	48

E përkohëshmjë "NORMALISTI," DEL NJI HERË NË MUEJ.

E botojnë nxânësit e Normales.

Editor: R. Hoxha '31. ndihmës St. Spasse '32.
Sekretar: D. Cara '31. " " I. Shishmani '32.
Arkëtar: T. Gusho '31. " " H. Rami '33.

Pajtimi: për gjashtë numra 2 Fr. ari
Nji numër kushton 2 Lekë.

Mbarimi i jetës shkollore për rendin '31.

Lajmëtimin e maturës, ase më mirë të themi të pjekmënisë, na e dha çpallja e varur në vëndin e posaçmë, e cila veç të tjeravet neve na dha dhe një gëzim shumë më të math, që shokët t' onë nuk' e kanë pasur: perjashtimin e lëndëvet për të gjithë.

Me daljen e çpalljes, për ne, u mbarua jeta e bankavet dhe fytyra e çdo maturanti tani ishte e gëzuar, se po i theshte lamtumirën ziles, që binte për të byrë e për të dalë në çdo orë; mirpo, përzjerë me gjithë këtë gëzim, dukej dhe një frikë në fytyrë të maturantëve, sepse të pas nesërmen, do të hynin të jepnin provën praktike në Shkollën Ushtrimore. Një mësim, që me të vërtetë të fut frikën e s' ke se si të përpiqesh për të dalur faqebardhë, mbassi duhet të jetë pak' a shumë i natyrshëm te çdo njeri e munt të fitohet vetëm me një praktikë të gjatë.

Provat filluan më 9 të Qershorit dhe mbaruan më 12. Brenda këtyre katër ditëvevet një lëvizje e gjallë i kishte pushtuar maturantët. Një hynte fytyrë çelët në rend, ku e prisnin nxënësit bashkë me komisionin provonjës, një dilte fytyrë prishur për punën, që kishte bërë. Çdo njeri u jepte një mendim shokëvevet, që prisnin ne dera, për vështirsitë, ase lehtësitë, që i dilnin para syshë. Sa gëzim, por edhe sa hidhërim. Gjithë puna këto ditë ka qënë ke fati: ky ishte ay, që bënte punën më të madhe. Çdo maturant i lutej Zotit, të cilin vetëm tani e zinte me gojë, që t i binte prova në rendin e dëshëruar, por, veç kësajë edhe ndonjë themë e lehtë.

Mbassi mbaruan provat e iku përfaqësonjësi i Ministrisë, për ne filloi pushimi për të bërë gati lëndët e tjera: Pedagogjin, Gjuhën e Matematikën. Ishte një kohë dhjetë ditësh Ishim në kulmin e mundimit e sidomos ata, që nuk i kishin përsëritur ndonjë herë këto lëndë. Vetëm pelerina dhe librat ishin këto ditë ngushëllimtarë për ne. Prej orës 7 gjer më 12, prej 2 gjer më 5, gjendeshim ndënë hijet e bukura të ullishtavet të qytetit me libra në dorë. Si shokë, për të shkuar ndonjë minutë me dëfrim, nuk kemi pasur vetëm se gjarpërinj, breshka e miza përdhecke, të cilat shumë herë i kishim edhe shëmbëll për punë! Çdo njeri prej nesh priste ditën e fundit për t' u shpëtuar

këtyne mundimevet. E me të vërtetë nuk shkoi shumë kohë e ardhë dita, në të cilën do të hyjmë në provim e të zbrazim gjithë atë, që kishim fituar: të xhvishnim atë petkën e bukur, që kishim veshë gjithë këto ditë! Provimet fillojnë njëri mbas tjetrit, më parë me shkrim e pastaj me gojë. Mafurantët nuk' i sheh të gjithë një: njëri është fytyrë zbëhtë, tjetri i zverdhur, njërit i janë skuqur veshët, tjetrit i dridhen këmbët: ku të di unë? Nga se vinë këto? Thue nga frika? A po se nuk janë përgatitur? As njera as tjetra. Vetëm e vetëm se ky i shkretë provimi paska hijen e rëndë. Është trembur Napoleoni e jo na, thoshin disa.

Mbaruan provimet, mbaruan. Gëzimi na ka pushtuar sa nuk tregohet. Fytyra e çdo njërit është e gëzuarë për së tepri, pse shpëtoi nga ky mundim. Gëzohet çdo njëri, po nuk' e di përfundimin e vet, vetëm gëzohet

Të gëzuar mblihdemi n' Internat, ia thuresim këngës, shkojmë në lulishten, ku për të parën herë ia bëjmë fora duhanit edhe konjakut. Mandolina bje, kënga kërcet, mirpo nga një herë mendja na shkon ke e nesërmja, pse ndahet fati i çdo njërit prej nesh, ndahet shapi prej sheqerit, si thuhet: del çpallja se kush fiton e kush jo, e pastaj me këngë, vijmë n' Internat për të fjetur. Cili është ay që fle? Cilin vallë e zë gjumi? As njërin.. Gjithë këjo natë na shkon me mendime për të nesërmen. E di secilido vehten se qysh ka dalë, por është një instikt ky, q' e shtynë të vepërojë kësajsojë.

Gëdhihet e nesërmja. Është ditë çlodhje, të them, por edhe një ditë historike për gjithë ata, q' e shohin emërin e tyre n' atë listën, që del më ora katër. Grumbull si nga hera, shkojmë në shkollë për të parë. Ç' të shohç o i shkretë! Çpalljen!! Një palë gëzohen, mirpo nuk e çfaqin, se pranë tyre kanë shokët, që puna e solli të hidhërohen, t' u mbushet zemra me vrer, të cilin e mbajnë të mbyllur në zemër, pa ja u treguar shokëvet të gëzuar. Ah! fat, fat!! Vjen dita që të na ndash duar, duar e nuk na le të rrimë të bashkuar si gjer tani! Nuk e çpjegoj dot këtë orë, s' mundem ta përshkruaj dot mimikën, kur pëqeshin dy duar të gëzuara ase një e gëzuarë e tjetra e helmuarë. Vetëm ay, që ka zemër të fortë munt të tregojë diçka mbi lottë e gëzimit e të hidhërimit të kësaj ore.

Bashkohemi pa ndryshim, nuk i lemë jashtë rrehtit edhe ata, që deri tani i kemi pasur e do t' i kemi të pandarë. Shkoj-

më grumbull n' Internat e prej andej bashkë me disa nga të parët t' onë shëtitmë rrugët e qytetit dyke kënduar. Po a të këndohet, kur për krahu të ka zënë shoku tënt i dëshpëruar! ? Si shëtitmë shkuam në kinema.

Përfundimi u-muar vesh, mirpo e Marta, më 30 të Qershorit, është edhe kjo për t' u-mbajtur mënt, sepse në këtë ditë do t' na njihej mundimi, do të na shpërblehej puna me një letër të qojtur "**dëftesë maturiteti** „, brëndia e së cilës është shumë e madhe se, veç gjithë të tjerave, shënon dhe fjalinë : „ **Asht i aftë për mësues** „. Kjo natë shkon edhe më mirë se e para. Më ora katër pas mes dite, më 30 të Qershorit, shkojmë në shkollë, e cila këtë orë kishte një ngjyrë tjetër: ishte si një " nuse me telë „, e dukej sikur nuk po priste nxënësit, që kishte pasur gjer dje. Dukej sikur kishte bërë gatitje për pritje e për-cjellje për nxënësit e 'saj, q' i ndahen një herë e për gjithënjë.

Të mveshur mirë si i ka hije një arësimitari, hyjmë dy e nga dy në drejtorit, ku ishin të gjithë profesorët. Drejtori, i cili me fylyrën e tij simpathike qëndronte kryenaltë, se i dhuroji shtetit nëndë-mbë-dhjetë mësonjës, na ndante diplommat dhe na thoshte udhën e mbarë me urime praktike. Këtë e bënin gjithë profesorët, kur na, mësonjësit e nesërmë, u shtrëngonim dorën për lamtumirën e fundit. Çdo njeri prej nesh u falej nderit për mundimin, që kishin bërë dyke na nxjerrë në këtë shkallë.

Si mbaroi edhe kjo, për të pasur kujtime të funtme, u-fotografuam shumë herë në oborrin e shkollës vetëm e me profesorë. Pastaj të gëzuar u-larguam n' Internat, prej nga grumbuj, grumbuj shkuam më orën shtatë në klub. Këtu veç Drejtorit me disa profesorë qenë edhe disa Normalistë të vjetër. Sa gëzim i math! Të rrjeshtuar për bukuri me drejtorin në krye shkonte ora si minutë. Gotat e birrës përpiqeshin pa prâ. Tymi i duhanit në qiell. Urimet për njeri t' jetrin, këngët e të qeshurat ishin të panumurta. Gramafoni këndonte këngët e 'tij. Fjalë u-thanë mjaft si prej Drejtorit, profesorëvet e nxënësve. Natë, që s' ka për t' u-harruar kurrë. M' ora dy-mbë-dhjetë, Drejtori me disa profesorë u-larguan dyke na thënë lamtumirën e fundit. Na me disa profesorë ndejtmë aty gjer më ora dy në mëngjes, dyke kënduar e dyke qeshur. M' ora dy, shkuam rrugëvet të qytetit dyke thirur " Bzzzz buuu „, nëpër dyerët e profesorëvet t' onë, që në këtë kohë ishin në gjumë! Kjo mbajti

gjer në katër e mbasandaj të kapitur arthemë për të fjetur.

U-gdhimë më 1 të Korrikut, ditë historike me të vërtetë, sepse në këtë ditë, mbas gjithë këtij gëzimi, po ndahemi me shokët t' onë të dashur, me të cilët jetuam pesë vjetë rrjesht, me ata shokë, që zunë shoqërinë më të madhe në bankat e shkollës. Ardhi ora e ndarjes! ah, orë! që me të vërtetë të kam pritur me gëzim. mirpo nuk' e dinja se qënke kaqë e hidhur, nuk' të dinja se ti do të ishe ajo, që do të na ndanje një herë e për gjithnjë me ata shokë, që hangrëm, pimë e fjetmë së bashku, na ndave prej shokëve, që kurrë ndonjë herë s' u thamë fjalë të këqija, veç se fjalë të mira; shokë, që i kishim treguar të mirat e të këqijat, shokë, që na janë bërë vëlla e motër, babë e nënë!

Kjo ditë s'ka për t'u-harruar kurrë; nuk ka për t'u-harruar, se në këtë ditë jemi ndarë me lot ndër sy, dyke përqaftuar njeri t'jetrin e dyke e porositur për t'u kujtuar jetën e jetës si vllëzër e dyke i thënë njeri t'jetrit të përpiqemi për t' u-bashkuar herë herë në shkollën t' onë të dashur, që s' kemi për ta harruar kurrë. Udh' e mbarë pra, mësonjës të rinj të '31: përpiquni për të mirën e arsimit t' onë, se prej nesh pret shteti sot. Të mos trembemi aspak prej vështirësive, që mund të na dalin përpara; le të kemi për shënjë gjithmonë atë të Shkollës s' onë: **Nalt e mâ nalt e mirë e mâ mirë.**

Lamtumirë o '31 i dashur.

R. Hoxha '31.

Ata që mbaruan Shkollën :

1) Ahmati Muharrem	nga Saranda
2) Bica Bajram	" Peqini
3) Cara Dervish	" Kavaja
4) Cerga Seluan	" Skrapari
5) Gega Muharrem	" Gjirokastra
6) Gusho Tas	" Pogradeci
7) Haxhihyseni Sulejman	" Elbasani
8) Hoxha Rahmi	" Bilishti
9) Hoxholli Behexhet	" Elbasani
10) Islami Shazivar	" Libohova
11) Jupi Myfit	" Gjirokastra
12) Jupi Neshet	" "
13) Kola Llaq	" Fieri
14) Papajani Lluizë	" Elbasani

- | | | |
|------------------|---|----------|
| 15) Riza Ibrahim | „ | Gjakova |
| 16) Sekuj Lazër | „ | Shkodra |
| 17) Vasili Pano | „ | Përmeti |
| 18) Zaimi Ismail | „ | Skrapari |
| 19) Zoto Mehmet | „ | Përmeti |

Historia e rendit '31.

Në Vjeshtën e vitit 1926 Shkolla Normale u- mbush me nxënës të ardhur prej vendeve të ndryshëm të Shqipërisë si edhe prej Elbasani. Ky grumbull nxënësish, i përbërë po thuaj prej nja 65 vetëve, bëri rendin gatimor 1931, me kujdestarë profesorin Z. Simon Shutëriqin, i cili qëndroi gjer më 1929-30. Viti Shkollor 1926-27 na shkoi pak si i ftohtë, sepse ishim të rinj, nuk njihëshim njëri me tjetrin, prandaj çdo njëri prej nesh përpiquej të zinte ndonjë shok për të bërë mësim. Rendet e larta ne i njihnim, por ata jo, nuk kishim as pak marrëdhënje me ta; ne hanim, pinim n' Internat se cili rend veç. Nxënësit e rendit t'onë s' kishin të drejtë të flisnin e të bisedonin për ndonjë çështje, kur bisedonin shokët e tyre më të mëdhenj. Këtë vit kemi pasur profesorë të ndryshëm, ishte një kohë që një vinte e tjetri ikte. Sporti kishte përparuar e rendi jonë pat nxjerrë lojtarë të mirë. Muzikë bënim vetëm vokale e jo violinë. Rendi '31 këtë vit tregohej si mjaft zelltar në mësimë kështu që prej 65 vetëvevet muntë të kalojnë për në rendin e parë 40 vetë, mbas një provimi q' i ngjet maturitetit të soçëm. Vitin shkollor 1927-28 po e shkojmë në rendin e parë. Ndër mësimë nuk pamë as një adryshim, vetëm se për mësimin e frengjishtes, tani e tutje na ardhi Z. Leblanc, profesor frances. Rendet e nalta na kanë zili për këtë, prandaj edhe ne gëzonemi që ja arrijtmë kësaj dite. Në këtë vit na u-shtuanë shumë shokë, të ardhur prej shkollave të mesme shtetnore. Sporti përparoi në rendin t'onë; formuam shoqëri të rregulltë, të udhëhequr prej prof. të gjymnastikës, Z. Sami Starovës. Mësuam për herë të parë edhe lojën e **basket-ball-it**. Shumë herë bëmë ndeshje në foot ball me rendet e tjera edhe fituam. Athletë, rendi i jonë nxorri tani, të cilët na nxuarr faqebardhë disa herë. Violinat këtu i zumë për herën e parë, por qysh tani vetëm disa tregonin interes për t' i mësuar ato.

Vitin shkolla 1928-29 e shkuamë në rendi e II të. Ishim

vetëm një a tridhjetë, mirpo numri i jonë u-shtue prap e ardhës nxënës prej shkollave të tjera, sidomos prej Liceut të Gjino-kastrës, i cili u-mbyll këtë vit.

Në këtë rend diçka na dukej vehtja e jonë, ishim rritur e kishim hyrë në radhën e atyre, që dinë të bisedojnë pak a shumë. Këtë vit na u-shtua psikologjia me profesorin e ri Z. V. Andonin, nëndrejtorin e soçëm, Bujqësia Theorike me Z. I. Haxhihysenin edhe Algjebra me Z. A. Dedën. Si profesor i Gjymnastikës na ardhni Z. A. Duhaxhiu, me udhëheqjen e të cilit rendi i jonë përparoi mjaft, kështu që në pakë kohë, me atletët që kish, mundën të fitojnë atletikën e lehtë për vitin 1928-29. Muzika vete jo keq. Nga mez' i këtij viti na u-largua drejtori i Shkollës s'onë Z. A. Xhuvani. Një grip e fortë na takoi këte vit edhe na mbylli shkollën për një muaj me radhë.

Ky vit për ne edhe për Shkollën Normale shinon një hap përparimi se ndërmjet nxënësve, që ardhën në rendin t'onë prej vendeve të ndryshëm ishte edhe një vajzë prej Normales së Korçës, Luiza Papajani, e cila qëndroi besnike e jonë gjer në ditët e fundit. Prandaj pra '31 është ay udhëheqës m' i parë për ta bërë Normalen të **përzjerë**.

Vitin 1929-30 e shkuamë në rendin e III-të, i cili u-çojt i IV-të për një ndryshim që iu-bâ në rendet e ulta të Shkollës. Ky është rendi m' i frikshëm e m' i rrezikshëm; lehtë të hysh në 'të, po me mundim të dalç. Si mësim të rinj na u-shtuan hospitimi në Shkollën Ushtrimore, një mësim shumë i vështirë, so do më të shumtën e kohës për t' u-kopjuar, edhe Didaktika me Z. S. Harrin, një mësim shumë i shijshëm, por i vështirë në fillim. Ky vit na solli një shumicë profesorë të rinj si Z. T. Telën të Matematikës, Z. H. Narazanin të Vizatimit, Z. K. Ljatjen të Punës së Dorës, Z. M. Krastën të Muzikës, Z. H. Podën të Bujqësis praktike, Z. P. Andonin të Gjymnastikës dhe Z. A. Foresi të Italishtes. Me ardhjen e Z. Andonit në Gjymnastikë, sporti përparoi mjaft, u-rregullun, veç të tjerave, edhe ndeshjet e foot-ball-it ndër rende, kështu që rendi i jonë me lojtarët e 'tij, mundi të marrë flamurin si fitonjës në football për vitin 1929-30. Rendi i jonë i dha shumë lojtarë të mirë Shoqënisë Urani, në kampionatin e këtij viti.

Muzika përparoi ndër ne, sidomos ajo teorikja.

N' Internat këtë vit përpiknia e disiplina është bërë e za

konshme, e shumë gjëra na u-përmirësuanë. Çdo gjë na dukej atëhere e vështirë, por sot jo. Me kohë u-bëkan të gjitha.

Vitin 1930-31 e kaluam në rendin e Vtë me kujdestar profesorin Z. I. Haxhihysenin. Jemi me të vërtetë në krye të Shkollës, por nuk krenohemi aspak; shoqërimi me rendet e ulta na është bërë gjë e përditshme: hamë, pimë bashkë, jemi më të mbedhenj vetëm nga mosha. Çdo gjë e bisedojmë bashkë. Në këtë vit na u-shtua prova praktike n' Ushtrimore, Edukata edhe Historija e Pedagogjis, si mësimet e reja. Frengjishtja na u bë prej Z. V. Andonit. Puna ka marrë përpara me hapa të shpejta. Rendi i jonë me gjithë mësimet e shumta, filloi përsëri Normalistin e humbur gjer tani edhe çfaqja dramën "Besa" të Sami Frashërit, me të cilën i dha të kuptojë botës se shkolla Normale ka njerëz për theatër.

Sporti në rendin t'onë është mjaft mirë, mirpo mësimet e shumta nuk na lanë të hyjmë në ndeshjet e foot-ball-it, kështu që, flamurin, të cilin ndoshta ishim të zotë ta mbajmë edhe këtë vit, ia dhamë rendit '34.

Muzika në rendin t'onë nuk pati anëtarë besnikë vetëm se dy a tre.

Kjo pra është një përmbledhje e shkurtër e jetës s'onë shkollore, e cila do të na bëjë të kujtojmë dikur shkollën, profesorët edhe shokët t'onë, me të cilët jetuam për pesë vjetë rrjesht si një shtëpi e madhe.

R. Hoxha '31.

Cili është rendi '31.

Shënim : Këtu po shkruajmë disa gjëra për jetën edhe për karakterin e atyre, që muarnë dëftesat e maturitetit. Jetëshkrimin e ka bërë secili vetë edhe karakterizimin e ka shkrojtur editorit; atë t'editorit e kanë bërë të tjerë.

Editori

Ahmati M., lindur më 30/3/1907 në Sasaj të Sarandës. Më 1918 hyri në shkollën e fshatit, të cilën e mbaroi më 1921; më 1922 ndoqi mësimet e rendit të IVtë në shkollën plotore të Delvinës. Mbas dy vjetësh pushimi hyri në Liseun e Gjironë-kastrës, ku ndenji gjer më 1927. Në këtë vit vjen në Normale si bursist, fiton provimin për rendin e II-të edhe e mbaron shkollën për katër vjetë.

Djal' i sjellshëm për shoqëri; me vullnet i vihet punës edhe

e mbaron. Ç' do gjë nuk' e tregon shpejt: e mban të fshehur. Punët i bën seriozisht, nuk ka dredhira. Gjithëmonë rri me fëtyrë të çelur, por është edhe nevrik i math: për një herë nxehet. Mësimin mekanik e ka shumë 'zët, mendon e gjykon, kur e flet fjalën. Mësimin e Gjuhës e ka fort me qejf, këngën e do fort, por vetë e jo me shokë.

Bica B., lindur në Peqin më 28/11/1912. Më 1920 hyri në shkollën plotore të Peqinit, të cilën e mbaroi më 1926. Ate vit pranohet me bursë në shkollën Normale, të cilën e mbaron për pesë vjetë.

Ka vullnet për punë; çdo gjë e bën me frikë, frikacak i math, por edhe nevrik në shkollën më të lartë: po të duash ziresh shpejt, mirëpo edhe kësajë i ruhet, po s' pati përkrahës. Të qeshurën e ka të zakonëshme për ato gjëra q' i di me siguri. Shëndetin e ruan shumë, se ka frikë mos i çpiket ndonjë shirit. Ka qejf të bëjë një çikë arithmetikë, se sa të qeshi e të lozi me shokë. Po t' i vihet pak mësimi, e mëson mirë për mendesh, duke dashur të mos harrojë ndonjë kryeradhë. I vjen keq po t' i shajshë ndonjë nga ata që i luten Zotit.

Cara D., ka lindur në Kavajë më 31/7/1910. Më 1918 hyri në shkollën Plotore të qytetit, të cilën e mbaroi më 1924. Mbas dy vjetësh, që ka ndenjur si praktikant në gjygin e Kavajës, pse nuk merrte dot bursë, vjen më 1926 si bursist në Normale, të cilën e mbaron për pesë vjetë.

Porsi ndonjë spanjoll, jo vetëm qesh, lot e këndon, por edhe natën s' pushon, të jesh ta dëgjosh. Fëtyra e 'tij s' vranet kurrë; nervoziteti tek ai nuk gjenë vënt, është për ta pasur zili. Shaje, rri fe, ai punon pas parimit të Jezu Krishtit. T' ishin këshitu të gjithë djemtë e hoxhallarëvet të Kavajës! Sportin e do me gjithë shpirti, vullnet ka mjaft për çdo gjë, por më tepër dëshëron Fizikën e pra edhe Arithmetikën. I pëlqen të rrijë pa qeleshe se sa me kapele. Mësimin e bën gjysmë mekanisht.

Cerga S. lindur në Verzhezhë të Skraparit më 25/3/1913. Më 1922 hyn në shkollën e katundit drejt për së drejti në rendin e II të, mbassi prindërit e kishin mësuar të këndojë e të shkruaj. Më 1923 hyn në rendin IV të, pse ishte bërë gati në kohën e pushimeve. Më 1924-25 bën rendin e V të edhe kërkon bursë për në Liceun e Korçës, mirpo ajo i u dhë për në Normale. Me qenë se nuk' kishte mbaruar rendin e VI të, e bën

këtë gjer më 1926 n' Elbasan, dyke ndenjur n' Internatin e Normales. Më 1926 fillon mësimet në Normale, të cilën e mbaron për pesë vjetë.

I çuditshëm fort, çdo gjë kërkon ta bëjë shpejt e shpejt pa menduar përfundimin. Syt i mban të mbushur me lot. Vullnet ka edhe punon mjaft. Stolin ia ka ënda. Do të jetë i rregulltë, i përpikët, por s' mundet. I shkreti Selmankë.

Gega M. është lindur më 1905 në Gjinokastrë. Edhe ky si mbaron filloren hyn në Liceun e me shumë mundime. mbassi sëmundjet i kishin rënë më qafë, vjen në rendin e IV të, mirpo më 1928 vjen në Normale hyn në rendin e III të dhe e mbaron shkollën për tre vjetë.

Burrë serioz, por me vënt edhe i qejfit. Nervoziteti tek ky nuk është zhvilluar aqë fort; mendon e gjykon shumë, kur flet. Vullnetin e ka të zhvilluar shumë. Mësimin ka qejf ta mësojë ashtu si e ka rrjeshtuarë libri. Është i mshehtë mjaft në punërat. Gëzimet me vënt ia ka ënda fort, gjithashtu edhe lojat pa tepri. Kur është në kulmin e qejfit të vet, i tepron disa shaka. Ndër mësimet dëshëron sidomos Historinë, për të cilën jep shpirtin.

Gusho T. lindur në Pogradec më 3/9/1910. Fillon mësimet më 1920 në plotoren e Pogradecit, të cilën e mbaron më 1926. Atë vit kërkon bursë për në Tekniken e Tiranës mirpo ajo iu-dha për në Normale. Me gjymës zemre niset për këtu, por pastaj i shtohet dëshira për këtë shkollë, të cilën e mbaron për pesë vjetë.

Ka qejf më fort të jetë i veçuar; fjalë nuk don shumë, por edhe as që flet, kur flet pak bën gabime shumë. Është sa i urtë, aqë nevrík. Gëzimet, lojat, etj. nuk para i dëshëron. Vullnetin e ka të fortë, është i rregullt e i përpikët. Mësimin e dëshëron ta bëjë gjithmonë me të mësuarën mjeshhtëriake e për këtë përpiket fort. Dëshëron të dijë nga të gjithë mësimet nga pak. Të ka fort zët, po t' i shajshë ndonjë t' jetër nër syt e tij.

Haxhihyseni S. lindur n' Elbasan më 12/2/1913. Më 1920 hyri në Shkollën Plotore t' Elbasanit, të cilën e mbaroi më 1926. Ate mot hyni në Shkollën Normale, të cilën e mbaroi për pesë vjetë.

Me gjithë që i vogël, gjykon e mendon, por për të mësuar mundohet pak, Për të të gjithë nxënësit e të gjithë lëndët janë

një: nuk bën asnji dallim. Vullnet ka por s' di ta përdori. Përpiknin e rregullën nuk e ka stërvitun. Jetën e lluksit nuk e do fort, sa që edhe qaforen e përbuz.

Hoxha R. është lindur më 3/5/1911 në Bilisht. Më 1918 hyri në Shkollën Plotore të Korçës. Që prej 1919 ndoqi mësimet e Shkollës Plotore të Bilishtit, të cilën e mbaroi më 1924. Në këte vit kërkoi bursë për në Normale, por s' mori dot, andaj shkoi në Vlorë për në Shkollën Tregtare e cila nuk u-çel atë vit. Prandaj u-largua edhe prej andej. Më 1925 kërkoi prap bursë për në Normale, por prap s' e fitoi, prandaj ndoqi mësimet në Medresen' e Naltë të Tiranës për dy vjetë rrjesht. Më 1927 i le ato edhe vjen në Normale, ku mbas një provimi fiton për në rendin e II-të e kështu e mbaron Shkollën për katër vjetë.

Është serioz, por i ngadalshëm; mësimet i bën e s' i bën, por Matematikën ia ka ënda aqë fort, sa që me zi-unda prej sajë. Përdor mënyrën kuptimore edhe ka logjikë, të cilën e përdor ngadalë. Nga një herë flet me "thuma e me zhega...", porse ka vullnet e punon mirë. Nervozitetin nuk e njeh: Mundet që nxehet, kur nuk e sheh njeri. Gjumin e do fort edhe i tlotë lamtumirë, mbas kumonës së tretë të mëngjezit! Merret me punë të mbëdha edhe frëngjishten e di mirë.

Hoxholli B. lindur në Elbasan më 1911. Më 1920 hyri në Shkollën Plotore të Elbasanit, të cilën e mbaroi më 1926. Atë mot hyri në Shkollën Normale, të cilën e mbaroi për pesë vjetë.

Flet gjithmonë e kështu diku bën edhe gabime. Fëtyra e tij rri të shumtën e herës e gëzuar; është i mirë për shoqëri. Me mësimet lëfton fort edhe s' bën as një përjashtim për ndonjërin. Sportin e do fort edhe dëshëron të rrijë gjithënjë mbi biçikletë.

Islami Sh. lindur në Libohovë më 25/5/1911. Më 1921 hyri në Shkollën Plotore të qytetit, ku ndenji vetëm dy vjetë; mbasandaj shkon në Tiranë, ku mbaron rendin e III-të e të IV-tin gjer më 1925. Këtë vit shkon prapë në Libohovë edhe mbaron rendin e VI-të më 1926. Atë mot vjen me bursë në Normale, të cilën e mbaron për pesë vjet, "dyke ia mbushur mendjen jeta shkollore me një radhë kujtime të paharruara, të cilat do t'i jenë ushqimi m'i plotë i shpirtit për kohën e ardhëshme", sikurse thotë ay vetë.

Pa përpikni e rregullë, dëshëron të bjerë të flerë herët e

të ngrihet vonë : djellin kur lint, nuk e ka parë kurrë. Mëson se detyrohet e jo se dëshëron, këtë e bën pse ka punuar, kur ka qënë m' i ri. Më fort se nga çdo gjë e pra nga mësimet dëshëron **muhabet**. Jo nevrík, por vetëm pak kryelartë; lluksi po thuej se i u-ngjit pas. Mëson shpejt edhe përdor mënyrën kuptimore. Pëlqen më fort frëngjishten për t' u-fjalosur. Oratorinë tek ky e gjenë mjaft të zhvilluar jo vetëm në mësim, por edhe në të folur. I zoti në muzikë e sidomos n' atë vokalen.

Jupi M., lindur në Gjirokastër më 1910 Mësimet e para i mori në filloren e në Liceun e atjeshëm gjer në rendin e IVtë. Më 1928 vjen në Normale, e hynë me bursë në rendin e IIItë. Në fillim të vitit të fundit i u-pre bursa, por nuk e lã shkoll n, të cilën e mbaroi për tre vjetë.

Nuk ka djallëzira, vështron pnnën e vet. i qetë, mendon e gjykon. Nevrik është, por e mban vehten shumë, Argëtimet i do, por jo të tepruara. Ka vullnet të fortë, e çdo gjë së cilës i vihet, e bën. Mësimin e bën me ate mekaniken; "Libri,, thotë, "nuk gënjen,,. Dëshëron më fort një bisedim të qetë e më fort të dëgjojë se sa të flasi. Përpiknia e rregulli te ky kanë vënt. Vetëm po i the për ndonji provë ta zhvillojë, mendohet fort.

Jupi N., lindur më 1908 në Gjirokastër. Si mbaron filloren hynë në Liceun e atjeshëm, ku me shumë mundime vete gjer në rendin e IVtë. Më 1928, kur u-mbyll Liceu, vjen në Normale, fiton bursë e hyn në rendin e IIItë. Në fillim të vitit të fundit i u-pre bursa, por nuk e lã shkollën, të cilën e mbaroi për tre vjetë.

Fjalaman i math. Ka gjithmonë ide radikale, po hyri në një grup njerëzish. Vullnet për punë ka e s' ka, mëson, kur del nga mësimi e jo kur hyn; i përpikët është, por edhe gjumin e ka fort me qejf. Mësimin do ta bëjë pa libër edhe sidomos shkencat. Gjithmonë qesh, por do të tallet; nevrík nuk bëhet kurrë, por të shet e të blenë.

Kola Ll., lindur në Grecall të Fierit më 16/3/1911. Më 1920 gjer më 1923 merr mësimet në shkollën e fshatit e mbarosandaj shkon në Fier, ku mbaron Plotoren më 1926. Atë vit merr bursë e vjen në Normale, të cilën e mbaron për pesë vjetë.

Gjithmonë fëtyrë gëzuarë. Nervozitetin diku e ka si shiu i Prendverës. Nuk zëmërohet kurrë. Vullnetin nuk e ka aqë të zhvilluar; mirpo punon pa pushim e del bukur në çdo gjë. I

përpikët e i rregullt jo aqë fort. Mësimin e mëson shpejt, por edhe e harron. S' lodhet kurrë të flasi në mësim, por s' lodhet edhe për rrëfenja të bukura, të cilavet u jep shijën e duhur me të folurën e 't'ij simpatihike. Dëshiron të jetë aktor në sценë. I mirë për shoqëri edhe këngëtor me të vërtetë, si Beratas. Si për çudi, nuk i zë besë vehtes, pesimist i math. Ka qejf gjithmonë, kur shih të bëjnë dyelo njerzë a kafshë.

Papajani LI, lindur në Mars 1914; hyri më 1919 në Shkollën fillore femnore t' Elbasanit, ku ndenji pesë vjet. Të gjashtin vit të Shkollës fillore e bëri në Korçë e po atje filloi mësimet në Shkollën Normale femnore më 1925. Mbas dy vjetësh n' atë Shkollë erdhi në Shkollën Normale t' Elbasanit më 1928 e hyri në rendin e III-të, kështu qi e mbaroi shkollën për tre vjetë.

Fjalamane e madhe edhe do të tallet me t' jetër kënt. Vullnet ka, por s' e rregullon dot; gjithmonë qesh. Kujtëzën mekanike e ka me vehte; po i the vetëm për Matematikë, të merr inat. Nuk është nevrrike, por e rregulltë dhe e matur në të folur. Jetën e lluksit nuk e pëlqen fort. Gjeologjinë e mëson mirë e shumë herë mbleth gurët e çmuarë.

Riza I, është lindur më 1906 në Gjakovë. Prej vitit 1916 deri më 1919 ndjek mësimet Shqipe në Gjakovë. Më 1922 merr bursë për në Shkollë të Bujqësisë në Lushnje, ku i ndjek mësimet gjer më 1923. Prej 1923 gjer më 1926 merret me tregti. Në këtë vit bëhet mësues në qarkun e Lumës, ku rri gjer më 1928. Dyke parë se detyrën, që kishte marrë përsipër nuk po e kryente dot, hoqi dorë prej asajë, mori bursë dhe erth në Normale më 1928; këtu hyri në rendin e III-të edhe e mbaroi shkollën për tre vjetë.

I matur në ç' do gjë, mendon, gjykon si burr' i pjekur e nuk i shpëton gjë pa e verejur mir' e mirë. Argëtimet e lojat i ka fort inat; do të rrijë i veçuar, pa i turbulluar ujët kujt, fjalë ka pak e ato me vënt. Vullnetin e fortë e përdor për të mësuar mësimet me mënyrën mjeshtriake. Rregullim e përpikni ka fort. Frëngjishten e do fort edhe është i tipit akustik. Nevrik është mjaft, por nuk e sjell punën gjer aty. Violinën e mbanë gjithmonë ndënë krye, sa për ta parë. Në jetesë është i thjeshtë, sa edhe qaforen e ve rrallë. Në Matematikë punon mjaft edhe

(Ka edhe më në faqen 33)

Edukata e fëmijëve.

Puna e mirërritjes së fëmijëvevet e ka tërhekun me të drejtë verejtjen e njerëzis që prej kohnavet më të vjetra, se prej fëmijëvevet të mirë ose të këqij varret lumtënia ose njerimi i familjes, i shoqnis njerzore dhe më në fund i shtetit.

Plutarku, fillosofi i vjetër i Greqis, ka dhënë shumë porosi e këshilla fillosofike për edukatën e fëmijëve. Nga ato po qekim këto më me randësi.

Puna më e parë, që duhet vumë re, është martesë e burrit me gruen. Burrit i përket të zgjedhi shoqen e jetës, të zgjedhi gruen, që i përshfatet atij, të tillë të mirë, të ndershme e të vjeshme. Urtësia e njeriut naltobhet atëhere, kur mund të lavdohet për virtytet e prindërve të vet.

Në mirërritjen e fëmijëveve tri gjëna janë, që duhen marrë parasysh: a) Natyra; b) Edukata; c) Ushtrimi e shprehija. Këtë gjë e shofim edhe në natyrë: Që të mundemi me marrë nga dheu fryte të mira, duhet të kemi, e para një tokë të mirë, e dyta një dorë bujku të zot dhe e treta farën e mirë. Me tokën e mirë këtu mund të krahësojmë natyrën e fëmijës me bujkun edukatorin e aftë dhe me farën edukatën. Të lumtuna ato fëmijë, të cilët do t'i kenë këto tri dhuni, d. m. th. që do të lejné me një natyrë të tillë të mbarë për ta edukue, që do të bien në duer edukatorësh të zott dhe së fundi që do të qëllojné në një jetë shoqnore me moral.

Por me këtë nuk duhet kuptue se, në qoftë që fëmija nuk pajiset prej natyrë me aftësi e dispozita shpirtnore të mira, nuk mund të veprojë mbi të edukata. Urtija dhe fuqija pedagogjike përmbushin me të plotë mungesa prirjesh e dispozitash të natyrës së fëmijëvevet. Tue pasun qindresë në punë, tue e rrokun këtë me zell të math, nuk kemi me hupë shpresën e guximin në luftën kundër dispozitave të pamira të natyrës feminoie. Pikat e ujit tue formue rrëkenat, gërryejnë malet; hekuri dhe çeliku hahen, tue u-prekun me duer; një tokë piellore, në qoftë se nuk punohet, ngel vend djerr; dhe e përkundërta ngjan, kur, një tokë gurishtë, tue u-plehnue mirë, jep fryte të mira. Gjithashtu edhe me anë t' edukatës e t' ushtrimit njeriut, në qoftë prej natyre i mbarë, në qoftë qi mundet me marrë një farë rritjeje, bāhet më i përsosun, në qoftë se prej natyre i pjerrun në të keqen,

edukata mund ti kufizojë deri diku të metat e 'tij, mund të zbusi pak ashpërit. (Didaktikë e Edukatë A, Xhuvani faqe 99).

Ligjëdhënësi i Spartës, Likurgu, që t' u tregojë bashkëqytetasve të tij se me sa fuqi vepron edukata, ushtrimi dhe shprehja mbi dispozitat e natyrës njerzore, muer dy langoj (zagarë), të lemë prej prindësh të njëjtë dhe njanin e ushqente në shtëpi, tue e mësuem e stërvitun në një jetë të qetë e të kandëshme e tjetrin tue e stërvitun në gjueti. Mbasandaj thërret në një mbledhje të gjithë bashkëqytetasit e tij, tue prumë para 'tyne të dy langojt, të cilëvet u vuni përpara një lepur dhe një çanak me gjellë. Njani nga langojt mësyni mbi lepurin, në vend qi tjetri i u-lëshue çanakut.

Mbassi Spartanët nuk mundeshin me e kuptuë qëllimin e prumjes së të dy langojvet, Likurgu u thotë : " Bashkëqytetas të mii, po shifni se, me gjithë që këta dy langoj kanë lemë prej prindësh të njëjtë, por nga rritja e ndryshme që u dhashë, njani u-bâ lakut dhe i egër, dhe tjetri gjuetar ,,-

Kështu pra, kur len fëmija, duhet të kihet kujdes që vetëm nana e vet të marri përsipër të rritunit e 'saj, se vetëm ajo do ta rrisi me dashuni të tepërme, në vend që dadot e detyrueme e të ngarkueme në mirërritjen e tyne, vetëm për hir të rrogës do të përkujdesen për to e jo nga dhimsunia, që ushqejnë për 'to. M' anë tjetër këte na e mëson edhe natyra që nana duhet të mandi fëmijën e 'saj, se në të gjitha shtazët këjo (natyra) dha qumësht mbas të lemit të fëmijëvet. Por përveç kësaj, në qoftë se nana do të mandi fëmijën, do të zhvillohet një simpathi e veçantë, pse të shoqnuemit fuqizon dashunin.

Në qoftë që ndodh ndonji herë për shkak sëmundjeje ose për diçka tjetër, të mos mundi nana të mandi kjo vetë fëmijën e 'saj, duhet të vëjë ré shumë në të zgjedhunit e mandeshës. Mandesha duhet së pari të jetë Shqiptare e jo e huej, se shpirti i ri, që ka m' u-formue, është i butë e i pa krijuem mirë. Për këte gjâ fillosofi i math i Greqis këshillonte të zgjidhen mandeshat me kujdes dhe përrallat të ishin të tilla të mira e jo asosh që mbushin fandazin e fëmijve me friksime e besime të kota. Pra nuk duhet që t'i lëmë fëmijët në duer mandeshash të hueja, se ato do t' i ushqejmë fëmijët me zakone e ndjenja të hueja; shpirti i tij nuk do të jetë shqiptarë, por do të mbillen në të ndjenjat e atij vendi, nga i cili zbret mandesha,

Po n' ate kohë duhet të kujdesemi edhe në punën e të shoqnuemit të fëmijëvevet t' onë me ato të të tjerëve, se sikurse thotë edhe fjala e vjetër. " kush shoqnohet me të çalin, do të mësohet edhe ai me çalue pak „.

S. Çaçani '29.

Provë-mësimi

Dhënë për maturë në rendin e III^{të} të Shkollës Ushtrimore.

Landa : Mësim jete.

Thema : Gojdhana e Mulizës.

Hyrja e këtij mësimi bâhet tue i pyetë nxânësit se ç' farë katundesh dinë nga t' Elbasanit dhe lehen të kallzojnë disa prej 'tyne. Në qoftë se nuk i përmendin ata katunde, për të cilët do të flitet në kallzim, mund të nxiten ose mund të kallzohen prej mësuësit. Këtu dëftehet edhe më ç' anë i bien këta katunde Elbasanit. Si të përmerdet Muliza. pyeten a kanë shkue aty ose a kanë ndi gjâ për ate. Në këte mënyrë flitet për Mulizën, si për vendin, kishën, një pemë qi ka aty. për vorrin qi quhet : " Vorr i bardhë „, etj. Flitet mandej edhe për Gurabardhin, Shelcanin, për krahinë e Shpatit, për natyrën e këtij të fundit si edhe për trimnin e Shpatarakëve.

Këtu flet mandej mësuësi : Me të vërtetë Shpatarakët janë trima. Unë po ju tregoj sot një luftë, qi është bâ ndërmjet të Turqvet e të Shpatarakëvevet në Mulizë. Shpatarakët kishin për kryetar Petro Kapidanin edhe kishin zânë vend në majën e njëj bregu mbi katundin Shelcan Turqit kishin zânë vend në shkrepin e Gurabardhit (Shkamb' i Letanit). Me qenë se ishin larg, i bijshin njani tjetrit përsëkundrejtmu me topa. (Flitet këtu se, kur janë ushtria larg në luftë, bëjnë luftë me topa, kur aviten, me pushkë e mâ në fund edhe me thika etj.). Tue luftue gjithnji po i aviteshin njani tjetrit edhe të dy anët uatakuen në Mulizë. Këtu u-bâ një luftë kaq' e madhe, sa qi mbetën nga të dy anët shumë të vramë, e gjaku shkoj rrkajë në Shkumbi. (Këtu lehen ata të mendojnë e të flasin vetë se kush është mundë e në këte mënyrë theksohet edhe mâ tepër trimnia e Shpatarakëvevet si edhe e gjithë Shqiptarëvevet, të cilët në çdo luftë qi kanë ra,

kanë dalë fituës) Trupat e njerëzve, qi u vranë, mbetën aty, deri sa zunë krymba etj.

Si u-thyen Turqit e prajti lufta, Shpatarakët ngulën në Shelcan e Turqit u-fërhoqën e u-vendosën në Bushek. Mbas disa ditëve Petro Kapedani u thotë shokëve : " U-vramë ç' u vramë, ndashti duhet ta godisim punën ndryshe, se gjithë ky gjak, qi u-derth, nuk është një punë e vogël, prandaj unë do të shkoj të piqem me kryetarin e ushtrisë Turke e të bëjmë me ta një paqë, se dhe ata janë bij nane e po vdesin për bukë. Mori pesëdhjetë shokë të zgjedhun, u varë në Bushek e shkoi drejt ke kryetari i Turqve. Ky e priti me nder të math. Kapidani i thotë : " Po shof se vuni mjaft si për çdo gjë ashtu edhe për të ngrënë, prandaj unë them të bëjmë një paqë : ju këtu të ndërtoni një mull të drithin ju a bie unë, e blueni edhe kështu rrojmë në paqë. (Këtu të flitet për bujarin e Shqiptarëve) Ai e pëlqeu mendimin e këtij, por i tha se nuk kishte lëndë. Kjo është një gjë shumë e lehtë, iu-përgjegj Kapedani. Dërgo disa njerzë në mal të Shushicës edhe disa të tjerë në Lleshan e t'u thonë qi t'u bjenë lëndë, se po i porosis edhe unë. Kur shkuen Turqit në Shushicë, i gjetën këta në këngë, e në valle e, kur shkuen në Lleshan, ata po lojshin shatorthi me gurë. U thanë për lëndë, por ata nuk ua vunë veshin fare. Mbas pak ditësh Petro Kapedani u-varë nga qaf e Bushekut me kol ngakuem me drithë. Kur mësoi se Shushica e Lleshani nuk kishin çue lëndë, se nuk dojshin me lanë dëfrimet, u-idihnie tepër e tha : " Shushica në valle e në gëzim e në urdhën të shokëve qoftë gjithmonë edhe Lleshanakët më parë u-zanqin me gurë e mandej me pushkë,,. (Këtu tregohet edhe pazotësia e këtyne katundarëve edhe se njeriu duhet të punojë e nuk duhet të rrijë kot në këte jetë).

Shkoi mandej vetë në mal, e qiti lëndën, edhe ia çoi kryetarit të Turqve. Në këte mënyë zuni miqësi të madhe me Turqit, të cilët mbas disa kohe, prej kënaqësis, qi ndjenë prej Kapidanit, i liruen tokat e Shqipnis. (Kallzohet këtu edhe shtëpia e Shqiptarve, të cilët me anë të disa dhuratave i ndoqën Turqit prej këndej).

Më në fund bëhet edhe një përmbledhje në pikat kryesore,

Provë-mësimi

Dhanë për maturë në rendin e I^{rë} të Shkollës Ushtrimore.

Thema : Shtyp Fjalësh Shembëllore.

Mësimi do të fillohet me një paragatitje, e cila do të ketë për qëllim t' u zgjojë interesin e t' u përmbajë kureshtë nxënësve për atë që do të flitet. Dihet se çdo mësim fillohet me gjithë farë të hymesh a paragatitjesh, por më e mira e të gjithave është ajo më e afërta e më e shpejta në ndërgjegjen e nxënësve; këjo hyrje do të mirret nga gjërat që kanë pa e ndëgjue nxënësit, mbë anën tjetër duhet të jetë edhe interesante. Mbassi një orë më parë bëhet vizatim mutini, mësimi lidhet me një herë me atë, tue i pyet nxënësit se përse na hynte në punë mutini ose më mirë se ç' farë pune bëjmë me t'ë. Këtu del puna e qumështit edhe shkon puna vetvetiu, tue i pyet ata se nga e marrim qumështin, që e hudhim në mutin; këtu natyrisht përgjegjia do të jetë se e marrim nga lopa, mund të thonë se e marrim edhe nga gjë të tjera si nga dhija e delja. Mirpo, mbassi punën e kemi me lopën, e nga ky mësim jete do të nxirren fjalët, atëhere mësuesi qindron këtu edhe fillon tue i nxjerrë fjalët llogjikisht nga mësimi i përmendur, tue i nxitë nxënësit që të gjëjnë vetë fjalët. Si të nxirret fjala lopa, do të ushtrohet më parë mirë me nxënësit, tue e thanë një herë disa nxënës veç e veç e mandej horas i gjithë rendi. Si të jetë mbarue ky ushtrim ndiqet methudha analytike më parë e mandej ajo synthetike. Qëllimi i të ndamunit në rrokje e në germa nuk është, që nxënësit të dinë se si me i nda në germa, por puna më e randësi është që nxënësit të shkathen nga goja e ta dinë se ç' tingull ka një rrokje. Si të jetë ushtruar fjala **lopa** në këtë mënyrë, atëhere del puna e të shtypunit në dërrasën e zezë. Kutija e gërmavet të shtypit duhet të vihet në një vënd, prej ku të shifet nga të gjithë nxënësit.

Për të shtypun fjalën **lopa** pyeten nxënësit se ç' farë ndigjojmë më përpara, ngrihet nxënësi për ta gjetun, e për ta vu në vëndin e duhun, porse para se ta vëjë në vënd do ta tregojë përpara gjithë rendit dhe do t' i thotë edhe emnin; e këndon nxënësi shkronjën e vume edhe shkon në vënd.

Mandej ngrihet një tjetër për të gjetë germën që vjen p. sh. o, prap edhe ky e nxjerr përpara nxânësvet dhe e vë në vend. Këtu herë, mbassi u-bâ një rrokje, këndohet prej nxânësit të ngritun e mandej prej të gjithë rendit horas. Ngrihet një tjetër për të gjetë germën tjetër p, edhe ky bân po atë punë, që bân shoku; prap edhe këjo fjalë këndohet prej nxânësit të ngritun e prej gjithë rendit horas. Po kështu bëhet për të gjetun germën tjetër a. Si të jetë mbarue së shtypuni fjala **lopa**, këndohet horas prej të gjithë rendit.

Mâ në fund pyeten nxânësit se ç'na jep lopa. Këtu dalin edhe fjalët e tjera që shifin në tabelët. Këtu duhet të ketë kujdes mësuesi që fjalët e daluna të jenë rrjeshtue mirë logjikisht, kështu që ato të bëjnë thelbin e mësimi. Sikurse ke fjala e parë **lopa** ashtu bëhet puna për t' i shtypë edhe fjalët e tjera, që shifin në tabelët këtu poshtë. Si të jenë mbarue së shtypuni të gjitha fjalët, atëherë këndohen prej të gjithë rendit horas.

Tabella.

Lopa, viçi, qumështi, tëlyni, mish, lëkura, brini.

I. Zaimi '31.

Provë-mësimi

**Dhanë për maturë në rendin e II^{të} të
Shkollës Ushtrimore.**

Landa : Të nxânë përmendsh.

Thema : Vjerrshë (Zamaku).

N' orën e parë kanë folë për lulet e kopshtit si b. f. për karafilin, trandafilin, zamakun etj. edhe mësimi i orës së dytë flet për njenën nga këto lule; për ket arsye, pra, pors i hyrje do të mjaftojë një lidhje e mësimi të kaluem me të tashmin, tuj i bân nxânësit që të diftojnë lulet e ndryshme, për të cilat kanë folë mâ përpara. Ndër të tjera që do të përmendin ka me kenë edhe zamaku; mbassi të përsëritet kjo fjalë prej disave e mâ në fund edhe horas, do të fillojë spjegimi i kuptimit të vjerrshës, tue hÿ edhe nxânësit në mësim.

Të shtyemun prej mësuesit, do të përmendin se këjo lule, si gjithë të tjerat, çilë në verë, edhe njerzija e don fort, se këjo

është më e bukura e ka erën më të mirë se të gjithë lulet t'jera. Thuhet mandej edhe se një fëmi i urtë, i cili rrin mirë, është i pastër nga trupi e i ndigjueshëm, aj është si zamak. Do të nxiten nxënësit të flasin edhe për bukurinë e erën e drandofilles, por një herit edhe për ferrat që ka ajo, prandaj njerzija e don më fort zamakun se drandofillen, sepse kur ai çilë në kohë të verës i afrohen e e prekin pa frigë, sepse ky pa i thërë i kënaqë me erën e bukurinë e tij.

Si mbaron spjegimi i kuptimit të vjerrshës, do të kalohet në të paraqitunit e dy strofave të para, mirëpo, në qoftë se nuk mundën me i nxanë të dyja bashkë, atë herë duhet marrë vetëm e para.

Në të paraqitunit, që duhet bërë nga dalë e kthjellët, nuk duhet harruar theksimi i fjalvet aty ku duhet, për veç kësaj nuk duhet me ndëjë pa lëvizje fare, porse fjalët duhen **përcjellë me mimikën e duhur**. Kujdes duhet të kenë edhe kur të bëhen lëvizjet e durvet ose përgjithnisht të trupit, të mos të jenë të teprume; çdo lëvizje e ndryshim i zanit duhet t'i përshtatet fjalvet e mbrendis së vjerrshës.

Si të jetë thënë vjerrsha një herë do t'u thohet edhe për së dyti, mandej do të iu spjegohet edhe fjalët e pakuptueshme si b. f. **I bāj më nderë** d. m. th. e due edhe e nderoj më tepër se lulet tjera; është edhe **A mbreti i luleve** d. m. th. se është i pari i të gjithë luleve e qindron më nalt se të gjitha. **E me dukë të kandshme**: edhe këte fjali nuk mund ta marrin vesht mbassi këtu kanë fjalën **dukë**, të cillën nuk e kuptojnë prandaj u-thohet se dukë d. m. th. pamje. Përveç këtyne fjalve u-spjegohen edhe të tjera si këto si b. f. **shenjon, ferrë** etj. tue ia krahasue me fjalët e vendit.

Më në fund paraqiten edhe një herë t'jetër strofat ose strofa e vjerrshës, por këtu mësuesi duhet të ketë kujdes, që t'i vejë mend mirë fëmivët. Për me mujtë me e mësue lypset që, kur ta thotë mësuesi, nxënësit t'i shkojnë pas me zë t'ultë e aj t'auli zanin pak nga pak e mb'anë t'jetër nxënësit ta ngrejënë deri sa më në fund ta thonë vetëm. Në këte mënyrë kështu duhet ta thonë nxënësit një dy a tri herë vjerrshën vetëm, e mandej cakton mësuesi njanin rresht të bankavet, që ta thotë, mbas 'tij t'jetrin, e kështu në të gjithë rreshtat; mandej fillon me pyetë nxënësit një nga një.

Si të mësohet strofa e parë ose dy të parat, duhet të paraqiten edhe pjesët t'jera po ashtu.

Kur të mësohet mirë edhe pjesa e dytë, thohet një herë e gjithë vjerrsha prej krejt rendit e më në fund çohen nxënës që ta thonë një nga një. Duhet pasë kujdes që nxënësit të jenë të qetë, të kenë vemendje e interesë për mësim ashtu edhe një fëtyrë të çelët. Aty ku duhet, të bëhet edhe të folurit horas si b. f. për fjalët **shenjon, pastr, ferra** etj.

Vjerrsha.

I

Përmbi gjithë lule,
Që dalin në verë,
Unë zamakut
I bëj më nderë.

III

Ka drandofillja
Dukë e shumë erë,
Por me ato ferra
Dorën më therë.

II

A mbreti i luleve,
A bukuri,
E me dukë të kandshme
Shenjon pastr.

IV

Vetëm zamakut,
Kur të çilin vera,
Pa therë pa t'vramun
I ndihet era.

L. Sekuj '31.

Provë-mësimi

Dhanë për maturë në rendin e III^{te} të
Shkollës Ushtrimore.

Landa : Mësim jete.

Thema : Peshqit e peshkatari.

a) Hyrja e përshkrimi i trupit : Sot dola në mëngjes buzës së Shkumbinit e pashë një a dy njerëz, që kishin përvesh pantallonat deri në gjunjë, e kishin hedhë një fije në ujë, vallë ç'ishin ata? Nxënësit: Peshkatarë. Mësuesi. Ç'farë bëjshin ata atje? Nxënësit: — Mësuesi. Të gjithë na kemi pamë, peshq, por të shofim se kush do të më kallzojë më shumë se qysh janë peshqit. Këtu do të lihen dy a tre nxënës, që të kallzojnë vetë ç' dinë për peshqit, pra të flasin prej parafëtyrimeve të tyre; kështu këto parafëtyrime të ndreqen ata që kanë qenë të gabueme, prej mësuesit tjetër iu nxjerrë përpara një peshk.

Muzeu i Shkollës Normale

Këtu do t' u lihet një farë kohë nxânësve, qi t' a rrokin mirë ate që iu paraqitet e pastaj do të pyeten se çfarë shofin te peshku. Nxânësit do të shtyhen t' a gjëjnë se kujt i ngjan peshku (njëj poçi llambe, por q' asht i shtypun për anash). Mbassi t' iu jetë paraqitun nxânësve i tanë, atëhere përflitet peshku pjesë, pjesë si kryet, qi e ka trikanës etj. Këtu do të pyeten nxânësit përse peshqit e kanë kryet më të ngushtë afër gojës. Nxânësit: Për me ça më mirë ujët. Pastaj do të përfliten sytë, brimat e hundës e veshët me gojën. Pastaj do të pyeten nxânësit se me se e ka të mbuluem peshku trupin? Nxânësit: me pare peshku. Do të tregohet këtu se peshqit ato i përdorin në vend të rrobeve. Mësuesi: Qysh janë vù këto pare te peshqit? Nxânësit: Janë vù porsit tjegullat e njëj shtëpije. Mësuesi po më ç' farë ka peshku? Nxânësit: ka bishtin, që hyn në punë për me kthye trupin. Mësuesi: po kambët ku i ka? Nxânësit: peshit nuk kanë kambë, por kanë fletë për të bëmë not. Mësuesi: Shikoni këtu, kur presim na ndopak dorën na del gjak e, po ta prekim gjakun t' onë me dorën t' jetër, do të shofim se ai është i nxehtë, por në qoftë se e presim gjëkund peshkun, kur të jetë gjallë, do të shofim se edhe atij do t' i dali gjak si i yni, por do të jetë i ftoftë. Pra qysh e kanë peshqit gjakun? Nxânësit: Peshqit e kanë gjakun të ftoftë; do të flitet edhe horas.

b) Banimi e të shtuemit: A e dini ju se ku rrojnë peshqit? Nxânësit: peshqit rrojnë në ujë; kjo fjali do të flitet edhe horas. — Kush do më kallzojë mue se qysh shtohen peshqit? Nxânësit: peshqit shtohen me ve; kjo fjali do të flitet edhe horas. Këtu do të tregohet prej mësuesit se këto i pjellin vetë edhe i venë në vende të ndryshme si në sipërfaqe t' ujnave e në fund pas tetë ditësh dalin peshqit e vegjël.

c) Ushqimi: Mësuesi: Po gjithë këta peshq, që shtohen kështu me se ushqehen? Nxânësit: Ata ushqehen me miza, me krymba etj; do të flitet edhe horas. Mësuesi: Ndigjoni ata qi janë të mbëdhenj hanë edhe peshq të vegjël.

ç) Peshkimi: Mirë, këta peshqit e mbëdhenj i hanë peshqit e vegjël, po peshqit e mbëdhenj kush i ha? Nxânësit: I hanë njerzit. Mësuesi: Po ku i gjejnë njerzit? Nxânësit: I zë peshkatari. Mësuesi: Pra kush i zë peshqit? Nxânësit: peshqit i zë peshkatari (do të flitet edhe horas). Mësuesi: po me se i zë peshkatari peshqit? Nxânësit: peshkatari peshqit i zë me grep e me

rrjetë. Këtu do t' u tregohen nxânësvet grepat e rrjeta e peshkatarit, pastaj do të flitet edhe horas : peshkatari peshqit i zë me grep e me rrjetë. Mësuesi: si i zë peshkatari peshqit ku i çon ? Nxânësit: I çon në pazar për t' i shitë. Mësuesi: ku shiten peshqit ? Nxânësit: peshqit (n' Elbasan) shiten te gryk' e mihanes (do të flitet horas). Mësuesi: Kush i blen peshqit ? Nxânësit: i blejnë njerzit. Mësuesi: ç' farë i bájme na peshqit ? Nxânësit: i bájme gjellë. Mësuesi: pra përse e duem na peshkun ? Nxânësit: Peshkun na e duëm për mishin e tij.

Së fundi bëhet një përmbledhje e shkurtën e sistematike.

M. Gega '31.

Novelë

Nder vorre.

Bân zëmer e mos u-ligsho Angjelinë, fati nuk do të jetë aq i praksuem, sa mos me na bekue një dashtni kaq të shëjtë — “ tha mjeku i cilli me dy sy të dhimshem e me krye vjerrtë, kqyrte shtratin, ku Angjelina, zbë si njajo lulja e dishrueme per ndoj rreze diellit, nuk prâte tue shterngue per zëmer dorën e tij. Syt i ishin bâ si dy gropa prej lotve, qi pa prâ njomshin faqet e saja, dikuer në ngjyrë të drandofillit. Nji të heshtun mbretnoi per disa çasta; .. mjeku me sy per dhë ofshâte pa da ... neper mende iu përshkojshin gjithfarë mendimesh kqyrte nga një herë Angjelinen, zemra iu-ndezte, gjaku i vlote e donte me u-shfrye kundrejt nj' atij, qi ishte mundue me i prishë at dashtni të kulluet, kunder s' cillës s' do t' u-gjindte t' jetër veç rrasës së vorrit ... Angjelina, dhe ajo s' prâte tue i pushue mbi te syt e saj; zemra i rrihte per s' teprit, krahnueri donte me i dalë vendit e hova hova, tue i lshue dhe ajo nga një t' ofshâmë, çonte mbulesat, kshtu qi filladi i ambël i vesës të mund ta freskonte pak at zemer të gandueme; dhe nuk bante t' jetër, veç mallkonte dhe ajo at shpirt-keq, i cilli ishte mundue me fikë njat flakë, qi nuk do t' u-shuente n' asnji mnyrë Por prap shpresa e një bashkimit të perjetshem e freskonte, ia lehtësonte dhimat e e bante me tretë nder mendime larg

të kaluemve !

Ishte Angjelina vajzë deret bujare e pajisun me të tana ato vertyte e cilsi, qi e bânjë njerin të çmueshem e të nderuem. E rritun si âsht ma mirë, pse vajzë e vetme, kishte marrë një hijeshi të rrallë nder shoqe të veta e bashkë me kte dhe një urti e pervujtni, e cilla ia shtonte ma teper bukurin. Do flokë të zezë e të shpeshtë i bijshin nëper ballë si kunorë e bukur e i bájshin hije syve të 'saj, qi vezullojshin si gurët e çmueshem. Koha kalonte dhe me 'te vjetët, . . në zëmer të 'saj kishte fillue me bi një lule e bukur, lulja e dashtnis, e kjo lule, ky drandofill i kuq, qi pak ka pak i kishte pushtuem të gjithë zëmren e s'e lente të qetë, pa dyshim do t' ishte Koleci, një djalë mjaft i mirë e i shkueshem, të cillin të gjithë e dojshin e e hatrojshin, por per mbi të tjerë Angjelina !. Krijshin fqijë, per ditë shifeshia me shoqishojnë e çdo bisedim të shkurtë, qi bájshin e percillshin me një buzë më gas, e cilla i mushte me knaqsi e iu njallte shpresë të reja atyne zemrave, qi kishin ra në një detë dyshimesh pa muejt me qitë per fushë çka koha do të zbulonte.

Kishte marrë Koleci doktoraten e mjekis, kur Angjelinen e kerkonte per fat një djalë i ri, teper i pasun i quejtun Henrik. Urtia e bukuria e saj, qi, si një drandofille, shkelxente nder shoqe, e kishin bā per vehte zemren e Henrikut; nuk donte t' jeter kend, veç asaj, e, në mes të ktij tallazi, qi pa prā ia lkundte shpirtin, ofshāte e kjante me zëmer; dronte mos ndoj' t' jeter kishte xānë çerdhe në zemer t' Angjelinës, mbassi i gjithë mundi, qi kishte bā me ia diftue dashtnin, i kishte shkue kot; e në kto mendime u-dishprote, kishte frigë se për 'te s' do të lente aj diell i dishruem e, tue mos pasë me ke me shfrye, u-grinte me vedi e flitëte si i hutuem. Prindja, tue pa gjendjen e djalit të vet, te i cilli kishin pshtetë shpresën e trashgimit të familjes së 'tyne, u-rropatne dhe në fund mujtne me nxjerrë shkajkun e shqetësimit të 'tij e me gjetë barin, i cilli mund ta shndoshte at zemer të helmueme prej heshtës së dashtnis,

Si njajo barka e voglë e gjetun në mes të njëj deti të pakufi e e rrethueme anë e mb' anë prej tallazeve, tue u rrahë e

tue u-perplasë, njashtu u-gjet zemra e Angjelinës, kur ndigjoi fialën e t'et, qi të tanë gëzim donte me ia kushtue një t'jetri. Kishte dashtë me kenë shurdhë per mos me ndi, kishte dashtë me kenë e verbtë per mos me pa; zemra per të paren herë i pikoi gjak, shtati i u-dridh, fëtyra i u-zverdh; ra në gjëj te kambët e babës, desht me e lutë, por vaji s' e lã e mbet si e hu-tueme pa mujtë me nxjerrë një gjysë fjale prej goje. Kjo ngjarje kaq e papritun e bëni t' anë mos të ngulet, por në një kohë ma të volitshine të kryete dishirin e Henrikut e me të edhe të vetin!

U-afrue nata, e Angjelina gadi e kputun e tue dnesë, ishte pshtetë te muri, qi e dante prej shtëpis së dashunit të vet e me dy sy të mekun shikjonte nalt si me dashtë me kerkue ndihmë e kshillë prej njatij, qi nuk dinte a thue e donte. U-err e qe se një derë u-ndi tue u-çilë e një njeri tue i u-afrue murit...! Ishte Koleci, qi si për gjithë nate përpara se me hi mbrendë, soditete plot mall Angjelinen ndëjë n' odë bashkë me prind.

— Kush je ti qi kjanë në kte kohë?! — pvet me çudi, por nuk pat t'jetër pergjegje veç një ofshë, qi si një thikë me dy teha, delte prej zëmres s' Angjelinës.

Prep pveti, e kte herë një " ah Kolec „ u-ndi si neper dhambë. Prej ktyne fialve zemra i u-trand, keci murin, i cilli ishte i ultë e pa pritë, kje gjetë afer njasaj, qi tesh sa kohë kishte ndrye në zemer.

Sikurse natyra në fillim të Prendverës pret vetëm një sh; me u-veshë e me u-stolisë me gjelbrinë, ashtu dy të rit pritne vetem këtë rasë per me i veshë shoshoqit petkun e një dashtnis së kulluet. Sa gëzim ndine ato zemra tue u-gjetë pranë njana t'jetres!; nuk e besojshtin se dashtnia, qi kishin mbajtë sejcilli mshehtë, kishte mujtë me i zgjatë fijet e veta të bukura e me i lidhë të dy bashkë në një mendim e në një dishir. I çilne zemren pa bjerrë kohë njani t'jetrit; Koleci ndigjote me çudi e zemrim kallximet e ngjarjevet t' Angjelinës e kjo në t'jetër anë tue pasë at dorë të butë në krahnuer të tij veshtronte kah i rrahte zemra u-knaqte e shpresa i u-shtonte. U-danë tue i dhanë besen shoqishojt, qi perveç rrasës së vorrit nuk do t' u-gjindte t'jetër fuqi me i bã ballë idealit të 'tyne, dhe në qoftë se fati do t' i

linte, dashtnia nuk do t' i lshonte kurrë.



I ati i Angjelinës nuk po mund ta gzonte n' asnji mënyrë zemren e Henrikut. U-rrahte e u-përplaste i ngrati djalë e me gjetë ndoj mjet per m' e shtrengue vashën ta merrte per fat, por kot. Tuj kujtue se shkajku do t' ishte, veç dashtnia, qi mund t kishte Angjelina me Kolecin, u-mundue e ia duel me i prishë dy familjet ndermjet, por, mbassi as kjo punë nuk bëni dobi, trilloi një dhelprni t' jetër.

Ardhë vera, familja e Angjelinës, kishte shkue me verue në një katund një a kater orë larg, mbassi vajza dita me ditë vite tue u-shkri. Nderkaq dhe familja e Kolecit kishte shkue per bëja një a tri orë larg qytetit e aty, ngrehë një barakë, kalonte djali ditët, tue pritë çasin fatbardhë me pa të dashtunen e vet veshun me rrobe të bardha në kraht të 'tij.

Qiti pra njerzë Henriku me përhapë fjalë te Koleci se Angjelina nuk gjindesh mirë me shndet e te Angjelina se Koleci ishte i smuet rëndë. Në këtë mënyrë mendonte faqeziu me bë gatimin e një rrene ma të madhe, e cilla shpresonte se do t' ia mbushte mendën Angjelinës se për 'të kishte mbarue shpresa e dikuershme e qi shpresë të reja do të njalleshin veç nën hijen e 'tij.

Kishte kohë qi dy të rit nuk dijshin gjë per njëni t' jetrin e një lajm kaq i papritun ua lkundi njëjt zemren. Pritshin me pa durim ndoj fjalë të mirë ndoj fjalë qi t' ua lehtësonte idhni-min, por kurrëgjë!. Henriku neper at njeri, qi perpara barshin fjalë e premtime t' ambla, dergonte tesh, mbassi e kishte thye me pare, lajme, te cillat ua shporojshin zemren anë e mb' anë. Mbas do ditësh u-hap fjala, në katund ku gjindesh vasha se Koleci kishte ndrrue jetë e te djali, se ditët e të bukures Angjelinë kishin perendue një herë e pergjithmonë!. Ç' rrfte ma të madhe mund të pritëte zemra e 'tyne, në një kohë, kur mendja u-shkonte tue endë ma teper se kurrë mendime t' ambla, mendime dasht-nijet, mendime të një jete të lumtun e të qetë?!

Ktë herë zen ra e vashës u-mbush në gjak e shperthei. Lë shtëpin e neper dritë të hanës, e cila i u-dukte në ngjyrë të

gjakut, u-vue me udhtue kah qyteti.



Në heshtimin e plotë të vorreve, hana derdhte rrezet e veta e shndriëte rrasat e lmueta tue i dhanë pamjen e ndoj drite, ndezë per shpirtë të të vdekunvet. Era e do drandofilleve e luleve të t' jera. bi n' at vend, u-shperndate kandshem nëpër ajri e mbulote hapsinen e vendit të shëjtë. Kah një derë e vorreve, një zhurmë kambësh. percjellë prej do lotësh e dnesësh të fikuna, filloi me e prishë at heshtim e një hije, tue kerkue vorr per vorr, shkonte tue njomë me lot búcat e dheut!. Prej derës t' jetër të vorrevet një t' jetër hije, tue u-pshtetë per një shkop e tue ofsha, u-shtynte gjithnji më mbrendë. Si u-gjetën per ballë, hija e parë ra per tokë e prej asaj duelnë si neper dhë " Ah Kolec „; hija e dytë, qi ecte si e hutueme, ndesh në 'të edhe ajo shtrihet per dhe tue thirrë me dishprimin e njëj njeriut të kputun e para grykës së vorrit. " Ah Angjelinë „ Dashtnia e dhima, molisë zemrat e dy të rive, i kishte bā të shkojnë me kerkue shoqishojnë e, tue pasë para syshë një humnere të pa fund, ishin vûe me udhtue kah vendi i perjetshem per me mbajtë besen e dhanme dikuer. Koleci n' at të rrëxueme, e ndjeu si n' anderr Angjelinen tue bertitë, mbloth fuqit e iu afrue Hana tue shndritë mbi fëtyren e 'saj të zbetë, i dha ndihmë me diktue të dashtunen e vet, m' e perqafë tanë vajë e m' e zgjue prej ati gjumi plot dhima, në të cillin e kishte hjellë dashtnia! Nuk i besojshin syve të tyne !! . . . Angjelina n' at kllapi u-gzote, kah kujtonte se shpirti i të dashtunit të vet në trajtë të një hijes, kishte ardhë m' e marrë per mos m' e lanë vetem e në dishprim . . . hapi krahat, por u-gjet në duert të një njeriut e jo të një hijes. Dhima, perzi me habi e gezim, i lā të shtanguem per do kohë deri sa, tue i dhanë zemer vedit, u çuene e u-nisne kah shtëpia.

Prindët e vashës po lojshin mendësh prej idhnimit; me gjithë qejf tash i nepshin liri vajzës së tyne me zgjedhë ke të donte per fat, mbassi i ranë në fije punës, por ishte tepër vonë. Qitne njerzë me kerkue, por kot, kshtu dita i kaloi në vajë e në dishprim të pamasë. Prej mbramjet një karrocë e ngrehun prej dy kualsh të shpejtë, iu-afronte viles së tyne !... dy njerzë të thithun në ftyrë prej ndoj pikllimit, gjindeshin mbrenda në

'te të pshtjellun sa ma mirë, si me drashtë, qi flladi i asaj nate të mos t' i bânte dam !. Karroca u-ndal e njerzit e shtëpis me gëzim e idhnim nji heri dulne e rrokne per zemer nji vajzë, qi me zi po qindronte në kambë !. Ishte Angjelina, qi me Kolecin vinte me qitë per fushë dhelpnit e Henrikut e me krye qellimet e veta të ndeshuna e të perplasuna neper male trazimesh. E lodhun e e kputun prej mundit të hjekun, ra e smundë per disa ditë e aty, tue pasë per bri Kolecin, qi shtëpia ia falne per fat, binte nder mendimet e ambla të kohës s' ardhshme larg të kaluemve !



Ishte ditë vjeshte, kur nji tubë karrocash të stolisuna tanë gëzim merrshin udhën kahë kisha, pershndetun prej nji mori gjethesh e populli.

Ksaj tufe i vinte ndesh nji shumicë gjindësh, me krye ultë e zymshem, tue mallkue morden, qi në kohen ma të mirë, kur bota fillon e i çfaqet njeriut mâ e kandshme se kurrë, e perlor kosen per të fikë fihisat e ri. Nji smundje e keqe i kishte pasë ra të ngratit Henrik e bâ me shkue e me gzue frytin e vepravet të veta me zëmer të breme prej krymbit të ndërgjegjes, qi dhe në fillë te mordes e paditete pa prâ, Angjelina e veshun krejt në të bardha, u-gjindte në nji nder karrocat mâ të bukura në krah të djathtë të Kolecit, tue vrejte me dhimë arken e të vde-kunit. S' kishte harrue gjithë të kqijat e sot në çastin mâ të bukur të jetës së vet, u-siellte kah Koleci me kerkue prej atij të falunit e anmikut e pak çasta mâ vonë, ndërsa mbi krye të 'tyne u-kndojshin fjalët e nji bashkimi të perjetshem, zemra e të dyve i bânte vend në valë t' atij gëzimi nji dhimë e njitë të faluni.

Z. N. Pali '30.

Dita e Verës në Lumë.

Populli i Lumës si ditë të parë të prandëverës njet të 14 tën ditë të Marsit, të cilën e presin me gëzim të math fëmijet e vegjël, me aqë gëzim, sa qi dy javë para bisedojnë pa prâ me njani tjetrin për 'të.

Nji ditë para, d. m. th. më 13 të Marsit, mbas dite, u lypin

cullët nânavet të tyne kumona kuajsh, dhensh e dhijs, të cilat, të kaluemen prakun e derës, i luejnë, qi të nxjerrin zâ. Nji, qi nuk ka kumonë, numërohet prej shokëve të vet si i pa gjâ të gjallë në derë; nuk përbuzet prej tyne, por dallohet në fytyrë se nuk e ka gëzimin e të tjerëvet, të cilët, për ta kënaqë shokun e tyne, shpesh herë i apin kumonat e veta.

Fëmijt e lagjeve të katundit e bájne për t' u-*pjekë* te ndonji vënd rrafshinë. Në të tilla vënde më 13 të Marsit mbas dite, përveç tufave të dhënve a të dhijsve e përveç grumbujve të lopve a të kuajve, shifën tuba cullësh, djemsh e cucash, gjashtë e deri në trembëdhjetë vjeç e bashkë me kumonat e shtázëve tingëllojnë edhe ato të fëmijvet.

Cullët aty fillojnë e luejnë gjithfarë lojnash. Asht nji dë-frim edhe për të mbëdhejt, kur shofin në ndonji anë të livadnit barijtë me shkopij e fyje në dorë e në tjetrën cullët e vegjël, të cilët mbas një a nji ore, pikaderdhen pyjevet, tue shkuem fëmijt e çdo shtëpije bashkë. Shpërndahen kështu, për të gjetë grumbuj mizash përdhecke. Në qoftë se ata të nji shtëpije takojnë më ndonji grumbull mizash, u vikasin shokëve të tyne, qi të mos lodhen tue kërkue atë qi dishërojnë.

Fëmijt e çdo shtëpije kanë marrë me vehte nga nji çorap e mbassi t' i mbushin plot e përplot me miza e dhé bashkë, ua apin atyne mâ të kujdesshëmvet. Ata mâ të mbëdhejt e porosisin shokun e tyne, qi të mos e lëshojë përdhé çorapin me miza e të mos eci teposhtë me të në dorë, se, po të bájë ashtu gjâja e gjallë e asajë shtëpije n' atë vjetë nuk kanë me pasë shtesë. Marrin në pyje edhe rrëma dushqesh me gjethe të mbëdha e asish me të vogla, d m. th. çarmashkull e çarfemën, të cilat ua apin ndonjënit, tue e porositë, si atë të mizavet, qi të mos eci teposhtë me to në dorë edhe të mos i lëshojë përdhe, se, po të bájë ashtu, e besojnë se djelmt e shtázët e shtëpisë, nuk kanë me pasë shtesë n' atë vjetë.

Mbasardaj nisen tue i rânë kumonavet edhe mblidhen n' ate vend, ku patën qenë mâ para; aty dëfrehen deri në kohë të mbrámjes e pastaj, mbassi të përshtënden me njani tjetrin, shpërdahen, për të shkue te shtëpijat e veta.

Bash kur është nisë bariu i dhënvet me tufën, kozari me dhijtë e lopari me lopët, për të shkue te shtëpija, atëhere shifen para dyerëve t' oborreve ata grumbuj cullësh, të cilët nuk hyjnë

mbrenda pa marrë lejen e të zojës së shtëpisë. Zgjidhet njëni prej tyre e thotë në derë këto fjalë :

— “ Ori e zoja e shtëpisë ! „ E zoja e shtëpisë përgjegjet : “ Ojë „. “ A je këtu ? „ E zoja e shtëpisë : “ Këtu jam e pleshta s' kâm, një a qi ke ngarkoj e shkoj „.

Disa zoja shtëpijet, mbassi e shofin se janë besime të kota, ata qi bëjnë cullët për ditën e Verës, nuk u apin përgjegjëje shpejt për së shpejti. Mbassi fëmijt nuk hyjnë mbrenda pa marrë përgjegjëjet e mbeten me mërdhifë përjashta praktik të derës, të zojat e shtëpijave shtrëngohen, qi t' u folin ashtu si dishërojnë loçkat e tyre. Mbassi të hyjnë mbrenda, i vënë më ndonji vënd të nal'ë gjënat e marruna në pyje. Pastaj marrin druna të gjatë, të cilët i çajnë deri në gjysëm dhe u fusin kashtë të thatë. Tue pasë ata në dorë të ngritun përpjetë, dalin n' arat e ndodhuna rëposhtë shtëpijave, ku ndezin kashtën; vërehet prej cullëve flaka e sajë, e cila besohet se, sa më halt të shkojë, aqë më e rritëshme ka për t' u-bamë bima e asajë are atë vjetë e se ka për të dhënë fryte të mjaftueshëm.

Kur barit' e dhënvet e kozarët e dhijvet i kanë mshelë tufat në vatha e loparët lopët e tyre në burgje, kur bujqit e drüvarët janë këthye prej punës, atëhere loçkat e njoma, të pahitun prej të rënmes sa në një vend në tjetrin, shifen të bëmë okol rrotull kolirit të zjarmit. Më 13 të Marsit në mbrëmjet, te shtëpijat nuk ndigjohet tjetër veçse bisedime të vegjëlisin, të cilëve nuk u shkon as buka atë natë prej gëzimit. Disa prej tyre nuk i merr edhe gjumi, se dishërojnë me u çue hejret në të nesërmen. Pra, gjelat ende s' kanë fillue me këndue, kur të vegjëlit janë çue prej shtratit. Fëmijt e çdo shtëpije, për të çue prej gjumit moshtarët e tyre, përdorin ujë të ftofët e për të zgjue ata të fqinjëvet, u bëjnë kumonavet. Besohet se cullët, e çuëm më përpara nga të gjithë në ditën e Verës, ua lëshojnë gjumin e pleshtat moshtarëve të tyre, të cilët, me gjithë qi e kanë vumë atë ujë në zjarr, nuk janë zgjue hejret, prej se i ka kapllue gjumi e kështu i ka zënë e vona në shtrat.

Para se të jenë çue të parët e shtëpis, futen në burgjet e shtëzve fëmijt e vegjël, njëni prej të cilëve ka çorapin me miza në dorë e tjetri rrëmat e dushkut çarrfëmën. Ua lëshojnë përdheket nën këmbë shtëzëve, qi të shtohen si mizat e tokës. I vënë rrëmat e dushkut çarrfëmën në dyerët e vathave të dhëve,

të dhijve e n' ate të burgjeve të lopvet, tue besuem se e shtu-
emja e tyne ka për t' u-bâmë me fëmna. Ata të çarrmashkullit
i vënë te dyerët e dhomavet, në të cilat flëjnë djelmënija, qi të
bâhet e shtuemja e tyne si gjethet e lisavet.

Bash përthijash çohen prej gjumit nânat, të cilat i veshin
me rrobe të reja fëmijt e tyne dhe u apin pëmë të ruejtuna për
atë ditë, si molla, arra, ftoj, etj.

Cullët, mbassi të hanë mëngjezin, dalin tuba tuba prej
shtëpijavet te ndonji livath, edhe thonë : " Hoj-ara-hoj petulla
me voj „; aty luejnë shiloras edhe lojën e cingëlit deri në mes-
ditë e pastaj shkojnë te shtëpijat. Mbas mesditës mbëlidhen
përsëri po n' ate vënd e dëfrehen përjashta deri në kohë të
mbrâmjes.

Kërthijat e njoma, mbassi të shkojnë te shtëpijat fillon me
i marrë gjumi, prejse janë lodhë tue bredhë sa në një ânë në
tjetrën. Prindët dishërojnë t' i kenë në tryezë të bukës të vegjëlit
e tyne, dëshirojnë ta hanë me to berrin e premë e për ditën
e Verës. Shumë cullë e zotnojnë vedin, për mos me i kapllue
gjumi deri mbas buket, qi të mos i lëndojnë prindët.

Të nesërmen, prej se shkoi dita e Verës, nuk shifet mâ ai
gëzim i përparëshëm te cullët.

R. Spahiu '26.

Vjerrsha për rendin e parë të filltores.

Shkolla.

Eni fmi, se ju due shum,
N' ket vend keni me kenë t' lum,
Un jam shkolla e juej gjithmonë,
Fmijt e mijë përhera m' donë,

Prindët e mi.

Ah, sa fort o prind ju due,
Se sa n' zëmër m' keni hi,
Pse mundohi shum për mue,
Tue më rritun me dashtni.
At' qi prinden s' e nderon,
Kurkush mirë, jo, nuk e don.

I vorfni e bâmirsi.

M' fal një pare t' ngratë.
 Thotë një fukara,
 Sa të blejë bukë thatë,
 Pse kam fmijët tuj kja !

E një fmi i mirë
 Afër shpejt i shkon
 Për 'të ka mëshirë
 Çka ka n' dorë ia lshon.

Dimni.

Dimni ia mbrini
 Me shumë furi
 E ne na ngrini
 Me borë e shi.

Porse aa kena
 Me çka m' u-xë
 Hjekë keq i vorfni
 S' ka t' mirë mbi dhë.

Kshtëja.

Jam e vogël rrumbullak,
 Jam e kandshme për marak,
 Prej malsijet vi, t' gjithë m' thonë
 Mirë se erdhe kshtëja e jonë !

Mica e dlorët e djali.

Djali : Mori micë, pse rrin tuj lpi
 Tuj fërkue kry e turi ?
 Mica : Eh, o djalë, m' duhet m' u-la,
 Pse kshtu njerzit m' donë sa s' ka,
 E, me bâ mos m' u-pastrue,
 T' gjithë kishin me m' largue.

Hartime nxanësish

Emni i atyne, qi punuen për atdhe, ka mbetun i pavdekun në faqet e Historis.

Sa e madhe është randësia e atdheut, nuk mund ta dijë çdo njeri. Atdheu është nana, gjaku, shpirti e nderi i çdo njenit prej nesh. Prandaj edhe dashunia kundrejt këtij e zën shkallën e parë ndër të gjitha dashunit, qi kaplojnë zemrën e njeriut.

Ata qi punuen për atdhe, a thue do të harrohen? Jo, për sa të jetë jeta emnat e 'tyne do të përmenden në faqet e historis. E pse? pse kanë punue për një idcal të naltë, për një ideal të shëjtë; kanë punue për atdhe. Janë sa e sa njerës, qi kanë shkri jetën e 'tyne për atdhe, por emnat e 'tyne nuk i kanë marrë me vehte, ata i kanë lënë të shkruem me shkronja t'arta në faqet e historis. Le të mos shkojmë larg, po të përmendim ata, qi punuen për këtë Shqipni. Skënderbeu, heroi i kombit t'onë, sa qe gjallë, punoi vetëm për atdhe tue luftuem për 24 vjetë me radhë kundër anmikut. Të mos harrojmë edhe Naim Frashërin, i cili, me krye nën gërshanë, u-përpoq për Shqipni e s' e kursei aspak jetën e 'tij për këtë vend të shtrëjtë. Ah, ku me i marrë burrat si këta të dy?! Janë të rrallë. A thue se do të harrohen ndonji herë? Jo, besa, besë për sa të nxëjë dielli dheun emni i Skënderit e i Naimit do të jetë i paharrueshëm në shpirtin e çdo Shqiptari, do të jenë të pavdekun në faqen e historis kombëtare; se këta ia kushtuen jetën këtij vendi, se këta e bënë detyrën, qi ka çdo njeri kundrejt atdheut.

Të due edhe unë, Shqipni, të due shumë, o Atdhe.

Gjaku n' dej, qi është tuj m'vlue,

Po prej teje m'ka burue,

Pra s' muj kurrë unë me t'harrue,

O Atdhe i dashtun e i bekue.

Muzeu i Shkollës Normale

Ta kam borxh pra gjakun t' im
 N' ty, për ty m' e derdhë, Atdhe,
 Se ti je po vend' i im,
 Vend' i dashtun, ku kam le,

Se ti je po nana e ime,
 Se ti je po zemra e ime,
 Se ti je po shpirti i im,
 Se ti je po nderi i im.

Y. Berisha '32.

ç' do gjë t' a vërteton.

Sekuj L. lindur në Shkodër më 22/2/1910. Prej 4 gjer më 7 vjeç ka ndenjur në kopështin fëminor të Shkollës së Çelës në Shkodër, gjer më 13 vjeç ka mbaruar pesë rendet fillore në shkollën franciskane. dyke e bërë dy herë rendin e IV të. Prej aty hyri në Kolegjin Saverjan, ku bëri rendin gatimuer edhe dy vjet të Gjymnazit Klasik Më 1927 erth me bursë në Normale, hyri në rendin e II të edhe e mbaroi shkollën për katër vjetë.

Të flet me seriozitet për ç' do punë. Do t' a tregojë vehten si burrë i math: fort qejf ka të tallet e t' u a hedhi të tjerëvet, pa kuptuar se edhe ata në këte kohë po i a hedhin. Bisedimin me njerëz të lartë e do fort. Nevrik pa masë, po të duash. Vullnetin e ka të mirë, punon edhe kupton. Për Histori tregon një interes të math. Egoismin për disa gjëra e ka të zhvilluar, po t' i shashë Shpirtin e Shënjtë, mund të çkëputet nga rrethi i tij. Për të mësuar vjerrsha n' Ushtrimoren është i vetëmi. Më mirë të lozë foot-ball se sa të hajë bukë. Nxe kuptuarshëm edhe kupton shpejt.

Vasili P. është lindur më 1911 në Delvinë (katunt i Përmetit); kur ishte tre vjeç shkon bashkë me prindët në Përmet; ku qëndron për gjithëmonë. Në moshën shkollore ka ndjekun mësimet në Shkollën Plotore të Përmetit. Shkollën e mbaron në moshën e vogël e me një shëndet të dobët, prandaj për dy vjetë rrjesht rri pa mësim. Më në fund kërkon bursë për në Liceun e Korçës, por s' e merr dot, e dyke qenë i shtytur prej të dashurvet të tij vjen në Normale më 1926 mjaft i dëshprëuar. Më 1927 merr bursën e kështu e mbaron Shkollën për pesë vjetë, dyke i u-ndryshuar mëndja e dyke i u-shtuar dashunija për këtë shkollë. Është me kundërshtim me ata që thonë se

lumtërija fillon me mbarimin e shkollës. Jeta shkollëore i duket nga më të bukurat e kjo e bën të ndahet me dhimsuni, si thotë ay vetë.

I gëzuar gjithmonë, nuk bëhet kurrë nevrík, mendon, gjykon e mëson si njeri i pjekur. Vullnet ka fort. Rregullin e përpiknin e ka fort qejf! Shaka bën shpeshë. Këngën e dëshëron shumë, kurdoherë e gjen me atë në gojë. Mësimet nuk u bën ndonjë veçim. Sportin e do me shpirt: pesë palë këpucë në vit gris. Në të biseduar të duket si burrë dyzet vjeç. Di të fjalosë mbas nevojës e mbas njeriut. Dëshëron një jetë të thjeshtë edhe pak gjumë në mbramjet.

Zaimi I. është lindur më 28/11/1908 në Ermenj të Skraparit. Më 1919 ka hyrë në shkollën Pjotore të katundit, ku ka bërë tre vjetë me radhë e mbasandaj ka ndjekur mësimet në plotoren e Beratit, të cilën e ka mbaruar më 1925. Qysh prej kësaj dite ndjek mësimet në gjimnazin e Beratit deri më 1928. Në këte vit merr bursë e vjen Normale, hyn në rendin e III të edhe e mbaron shkollën për tre vjetë.

Njeri i paqëndrueshëm në punë. Do të bëhet si të thotë ai; e po të jetë e mundur të bisedosh me të do si e si të ta hedhi. Fëtyra qesh vetëm përmbrenda se përjashta rin shumë e fshehur. I flet një soj si profesorit ashtu edhe nxënësit t' Ushtrimores. Është edhe pak nevrík, e po u-nxe **mezallah** se ia këthen mëndjen. Punon; në mësim përdor mjaft atë kuptimorën edhe e fut në punë sidomos në Histori Natyre e Gjeologji, ku dëshëron studime e spjegime. Fort qejf ka të jetojë në majë të Tomorit. Ndjenjën esthetike e ka të zhvilluar mjaft, por nuk e tregon.

Zoto M. është lindur më 14/5/1910 në Hotovë të Përmetit. Mësimet e para i ka marrë në Shkollën e katundit, mbasandaj ka shkuar në Përmet, ku ka mbaruar plotoren më 1926. Qysh prej kësajë dite deri më 15/1/1927 ka ndenjor pa punë, mbassi lutja që kishte dhënë për bursë i u-pranua vonë: vjen në Normale, të cilën e mbaron për pesë vjetë.

Burr' i shkurtër e mustaqe-math. Gjithmonë dymbëdhjetë i rreh ora. Aqë fort nuk mendon e gjykon; si të dalë le të dalë thotë, po ta kemi të thënë këshu; e le punën në dorë të Zotit! Vullnet ka mjaft, se po të mos kishte atë lum Hotova. Gjithnjë qesh e tallet e po ju shkrep për ndonjë send lere ta mbarojë të vetën. Të rrjeh e të bëjë hartim e pra të çvillojë ndonjë

themë i duket minuta ditë. Si në të folur e në të shkrojtur dy fjalë mundet q' i flet e i shkruan bashkë. Të mësuarën e bën me ate të shkretë mekanike. Nuk pranon asnjeri mbi vehten e vet. Çudi! Dëshëron bisedime me njerëz të lartë.

R. Hoxha '31.

Vjerrsha.

Prindët.

Kush na leu, na qiti n' dritë
E kush lutet natë e ditë
E kush tepër ka dëshirë,
Qi të jemi njerzë të mirë
Me zotsi e urtësi?

Prindët.

Kush na rriti, na ushqe
Kush na tha ne se Atdheu
Vend i shejt, ásht, do ta dojmë
Edhe kurrë t' mos e harrojmë,
N' çdo vend t' jetër, qi të shkojmë,
Na me zemër ta kujtojmë?

Prindët.

Kush kënaqet, s' ka mni,
Edhe buza shpesh i qesh
E n' gëzime zemra i ndesh,
Kurse shef se vepra t' mdha
Po prej nesh dalin pa-da?

Prindët.

Y Berisha '32.

Përkthime :

Një ngjarje kusarësh.

(Paul-Louis Courier)

Zonjës Pigalle.

Një ditë udhëtonja në Kalabri. Sikurse e di dhe ti, në një vënd plot me njerës të liq, të cilët, besoj, nuk duan asnjeri dhe i urrejnë Francezët. Që t' ju them se përse, është një punë e kotë dhe do të zgjati shumë; mjafton që na urrejnë

për vdekje, dhe munt të vuash shumë, kur bie në duart e tyre. Kishja për shok një djalosh me një fytyrë . . . për zotin, porsì t' atij zotris, që e pamë në Raincy; a të kujtohet ? në qoftë se jo, ca më mirë. Nuk ju a them këtë gjë që të interesoheni, por pse kjo është e vërteta. Në këto male rruga shkon nëpër gërxa dhe kafshët ecin me mundime të mëdha. Shoku i im, dyke shkuar përpara, për pakë më hodhi jashtë rrugës, sepse ajo i u duk si më e mbarë. Ky qe gabimi i im; sepse s' duhej që të besonja një djalosh si ky, njëzet vjeçar. Para se të errësohej dita, kërkojtëm nëpër pyll, por më kot; sepse sa më shumë e kërkonim rrugën, aqë më shumë e lun bisnim; dhe gjer sa gjetëm aty afër një shtëpi të zezë përjashta, ishte errur mjaft. Hyjtëm me dyshim se s'kishje se ç'të bëje. Aty gjetëm rreth njëj tryeze të gjithë familjen e njëj thëngjilltari, e cila na ftojti të hyjmë. Djaloshi i im nuk' e bëri gjatë, por me një herë u-shtrua mirë dhe filloi së ngrëni dhe së piri; kurse unë po kqyrnja vendin dhe tiparet e 'tyre. Pritësit t' onë kishin me të vërtetë një tipar thëngjilltari; por shtëpija e 'tyre i ngjante njëj arsenali. Nuk kishte gjë t'jetër veçse dyfekë, kobure, thika, këllëçë e hanxharë. Të gjitha këto gjëra kështu nuk më pëlqyen aspak. Shoku i im, mb'anë t'jetër dukej sikur ishte i shtëpisë; qeshte dhe fjalosej me 'ta. Unë, sikur e dija dhe më përpara që ky do të thosh se ç'kish ndër mënd; u tha se nga vinim, ku shkonim dhe cilët ishim. Pa mejtuhu pakë, një frances i vetëm dhe shumë lark prej ndonjëj ndihme njeriu, të bjerë në thonjt e këtyre armiqvet t' onë, që na urrejnë gjer në vdekje! Por m' e keqja, e cila munt të na humbëte, ishte kur ay e bëri vehten të pasur edhe i u zotua këtyre për shpenzimet dhe për udhëheqësin e nesërm. Më në funt filloi të flasë për valixhen, dyke i u lutur që t' i kishin kujdes dhe t' i a vinin te kryet e shtratit. Ah! djalëri, djalëri! ç' është për të qarë jeta t' ende! Kushërirë, besuan se ne kishim me vehte gjithë diamantet e kurorës. Halli i 'tij i madh, që bënte gjithë këto fjalë me 'ta, ishte se brënda në valixhë kishte letrat e së fejuarës së 'tij.

Si mbaroi darka, shkuan për të fjetur, se odën e fjetjes e kishin për ndënë odën t' onë, ku u-darkuam. Një vënt i ngritur ndo nj' a shtatë a tetë këmbë, ku munt të hypje me një shkallë; një si çerdhe, në të cilën munt të hyje rrëshqanthi ndënë trenjt e ngarkuar me ushqimet e vitit. Shoku i im u-ngjit vetëm dhe

fjeti duke u-mbështetur mbi valixhen e çmuar. Unë me qenë se kishja vendosur që të mos flija, por të gdhiesha, nderza një zjarr të mirë dhe u-ula pranë 'tij. Nata kishte shkuar, thuaj se e tërë, në qetësi, dhe, porsa kisha filluar që të sigurohesha; n' atë kohë kur drita e mëngjezit nuk ishte shumë lark, ndëgjova përposh thëna gjilltarin, i cili po fjalosej me të shoqen. Dhe unë duke vënë veshin tek oxhaku, i cili lidhesh me atë të odës së poshtme, ndëgjova kthjelltë këto fjalë të burrit: "Mirë pra! më në funt shofim, në duhet t' i therim që të dy...". T' jetër fjalë nuk ndëgjova për veç se një "po..." të gruas së 'tij dhe zërat humbën.

Qysh t' ju a them? Rrija dhe mezi po merrja frymë, i tërë trupi i im m' u-bë si mermer; dhe sikur të më shifje, nuk do të mundje të më dalloje në ishja i vdekur a i gjallë. Oh Zot! kur e sjell ndërmend!..... Të dy bashkë pa ndonjë mjet lufte me vetëhe, kundra atyreve, që ishin dymbëdhjetë a pesëmbëdhjetë e më shumë, kurse shoku i im ishte në gjumin e parë, i vdekur së lodhuri!. T' a thrrisnja; të iknja vetëm nuk më bënte zëmëra; sepse dritarja nuk ishte dhe kaqë e lartër, mirpo përposh dy qenë ulërinin si dy ujçër!.

Në ç' mundime të mëdha po gjendesha merre me mënd, në qoftë se do të mundesh. Pas një të katërtë ore, e cila m' u duk shumë e gjatë, ndëgjova nëpër shkallët që dikush ngjitej, dhe, prej krisavet të portës pashë babën, i cili në njërin dorë mbante llambën dhe në t' jetrën një thikë, e, dyke hipur shkallat, i vinte pas e shoqja. Unë ishje prapa portës, kur u-hap porta; por para se të hynte, vuri për dhe llambën, të cilën gruaja e 'tij erdhi dhe e mori. Pastaj hyri këmbë zbathur, kurse ajo nga përjashta i thoshte me një zë të ulët, duke i vënë dorën llambës, që të mos i përhapej shumë drita: "Shko me nga dalë...". Kur ishte në shkallët vuri thikën e 'tij në dhëmbë, dhe, si erdhi, në krye të shtratit, ku djaloshi i shkretë, i ndërur, e kishte bërë gati grykën, me një dorë zuri thikën, dhe me tjetrën... Ah! kushërirë! kapi një kofshë mish derri të thatë që mvarej në tavani, preu një copë dhe iku ashtu sikurse kishte ardhur. Porta u-mbyll, llamba iku, dhe unë ndënja vetëm në mendimet e mija. Porsa çeli dita, gjithë familja u-ngrë me një zhurmë kaqë të madhe, sa që na krejtën gjumin, sikur t' i kishim porositur. Na prunë ngrënjen e mëngjezit shumë të pastërtë dhe shumë të mirë. Dy zoq pule të vegjël, për të cilët na tha i zoti i shtëpisë,

që njërin t' a hanim dhe t' jetrin t' a mernim me vetëhe.

Dyke i parë këta, atëhere e mora vesh kuptimin e atyre fjalëve të frkshme : " a duhet t' i therim që të dy „.

Besoj, kushërirë, se ju jini mjaft e zgjuar dhe do t' a gjeni shumë shpejt kuptimin e atyre fjalëve.

Ju lutem pra kushërirë të mos e kallzoni gjëkund këtë ngjarje. Sikurse e shihni edhe ju vetë, munt të m' a ngatërroni. Shiko, nuk qëndron puna aty, po fytyra e juaj nuk do të bëjë as një vrragë të vogël, kur do t' a kallzoni këtë. Por unë, t' i lëmë mburrjet më nj' anë, e kam vetiut fytyrën për të kallzuar përralla dhe t' ju fut frikë ndëgjuesvet. Mirpo me qenë se ti ke qejf për të kallëzuar të këtilla punëra, të cilat i përshtaten me të vërtetë fytyrës t' ende. merr për shëmbëll Psyché-në.

Përkthyer prej

F. Kekezi '32.

Çerdhet e zogjvet.

(Chateaubriand)

Porsa zhvillohen fletët te pemët, një mijë punëtorë fillojnë punët e 'tyre. Këta sjellin fije kashte nëpër yrimat e ndonjëj muri të vjetër. ose ndreqin ndërtesa nëpër dritaret e ndonjëj kishe; të tjerë rrëmbejnë qime të ndonjëj kali, ose fillin e leshit që e ka lënë delja të mvarur nëpër gjëmba. Ka druvarë, të cilët kryqëzojnë bisqe të vegjël në majat e drurëve, edhe endëse, të cilat endin mëndafshin mbi gjëmba.

Një mijë pallate ngrihen dhe çdo pallat është një çerdhe. Çdo çerdhe shëh ndryshime të bukura : një vë e ndritshë me pastaj një zok i mbuluar me push të verdhë. Kur këtij zogu i dalin pëndët, mëma e mëson të fluturojë mbi çerdhen e vet. Pastaj vete gjer te buza e djepit të 'tij, edhe i heth një sý për herë të parë natyrës. I trëmbur, por edhe i gëzuar, kthehet te vëllezërit e 'tij, të cilët edhe nuk e kanë parë këtë pamje. Por, i thirur përsëri prej zërit të prindëvet të 'tij, del për së dyti nga çerdheja. Ky mbret i ri i erës, i cili mban akoma kurorën e foshnjëris mbi kokën e vet, guxon prapë të vëzhgojë qiellin e paanëshëm, majat e pishavet që lëvizin prej erës edhe thellësitat e bleruara nënë lisiin atëruar !.

Në këtë kohë, knr pyjet po çmallen nga gazi duke pritur

banorët e rinj, një zok plak, i cili e kupton dobësin' e 'tij, vjen të rrijë pranë një rrjedhjeje uji: Këtu, i pushtuar dhe i vetëm, pret i qetë vdekjen në buzë po t' atij lumi, ku një herë këndoi dashurit e t' ij, kurse drurët mbajnë akoma çerdhen edhe kujtimet e 'tij të ëmbëla.

Përkthye prej

F. Kekezit '32.

Gojdhana:

Dibranët janë Mirditas. Si erdhën në Dibër.

Kur sundojshin në Shkodër Balshajt, në Gjinokastër Arinjanitasit, në Durrës Topijajt dhe në Duka jin Dukagjinasit, në Mirditë, na thotë gojdhana popullore, qi po kallzojmë më poshtë, sundonte një princ, qi quhej „Doçi i Lurës „; quhej kështu, se ishte prej katundit Lurë të malësis së Dibrës.

Princ Doçi e kishte kryevëndin e 'tij n' Orosh, i cili ishte atëhere një qytet n' a 12000 banorësh. Principatën e Doçit e ndajshin prej Dibrës majet e malevet, qi naltësohen në breg të Drinit (d. m. th. se ka pasë edhe një pjesë të Matit) Ky princ e lakmonte tepër fushën e Dibrës, mbassi vëndi i 'tij ishte shkrep e pa farë prodhimi. Dibra në këtë kohë kishte një popullsi po thue se krejt bullgarë, me të cilën ai kishte bâ lufta të papreme për me shkëputë ndonji copë fushë; por Bullgarët i kishin kundërshtue me fuqi të madhe edhe nuk e kishin lanë të bâjë as një hap këndeje majevet të malevet.

Në këtë kohë Sulltan Murati me Turqit zbriti në fushën e Kosovës për me mbarue qëllimin e 'tij, të pushtojë Ballkanin; Sërbët e Bullgarët të bashkuem i duelën përpara për me i prë hovin, në kët lidhje hyni edhe Balsha i Shkodrës. Princ Doçi, për me fitue nga kjo punë e çpalli vehten kundër Bullgarvet dhe mbajti anën e Turqvet. Bullgarët të zemruem nga kjo gjë, dërguen ushtri të padame kundër 'tij, por ai u bëni ball dhe nuk i la të kalojshin Drinin.

M' anë t' jetër në Kosovë lufta qe e përgjakëshme: Sulltan Murati u-vra' ashtu edhe krajli i Sërbis; me gjithë atë lufta nuk po shuhej e dukesh më tepër se Turqit po mundeshin. Edhe do t' ishin mundë, po të mos i kishte ardhë Sulltan Mehmetit,

trashigimtarit të Sulltan Muratit, një ndihmë e papritun prej një gruaje katundare. Kjo grue quhej Mari; ishte shqiptare prej katundesh të Kosovës dhe e bëni këtë punë, për shkak se Sërbët i kishin vra të birin, kur ky desh me qitë prej duervet të tyne një cap, qi po ia mirrshin.

Ajo vjen ke Sulltani dhe, mbassi merr leje me anën e atyne, qi rrejskin çadrën e 'tij, hyn mbrenda. Çadra ishte e shtrume me qilimë dhe në krye të 'saj, pak si n' anë të djathtë, ishte ulë Sulltani në një shilte krejt n' ar. Katundarja po sa hyn mbrenda portës së çadrës bije në gjû sikur e kishin mësue përjashta; por e zû turpi përpara Sulltanit dhe nuk mundi me e çelë gojën. Sulltani me një zâ t' ambël i thotë :

“ Përse ke dashtë të fjalosesh me mue bija e ime ? „

Katundarja merr vehten atëhere dhe i thotë :

“ Unë jam një katundare prej katundit Papiieviç të Mitrovicës. Sërbët më vranë djalin për mall dhe më lanë qyqe vetëm —. Për me marrë hakun, erdha t' ju dëftej një gjâ, qi të fitoni luftën. Ushtarët e sërbëvevet e të bullgarvet janë veshun krejt në tel dhe, për mos me iu dukë petkat teli, kanë veshun mbi këto petka leshi. Prandej shtizat e ushtarve të tu nuk mund t' i shpojnë ata. Ti t' u japish ushtarvet të tu kosa të gjata edhe të hynjë nëpër ushtarët serbë e bullgarë e t' u shkurtojnë kambët. Me këtë mënyrë ata do të munden, dhe gjithë vëndi t' onë ka me qenë i yti „.

Sulltani u-mahnit, kur muer vesht se cili ishte shkakqi qi ai s' po fitonte luftën; me gjithë atë nuk e bëni hë për hë se kishte nevojë me marrë këshilla prej një gruaje katundare dhe me një zâ të qetë i thotë :

— Si të quejnë moj bijë ?

— Mari.

— Prej ç' katundi më the se je ?

— Prej katundit Papiieviç të Mitrovicës.

— Unë këtë nder due të ta shpërblej; kërko ç' të dësh prej meje. —

Marija i tha :

“ Unë s' due t' jetër gjâ, vetëm se të më japish dorë se katundin t' im ke me e lanë të lirë e të pangamë në fë në jetë të jetës; edhe unë, sa të jem, të jem e para e 'tij „.

Sulltani me gjithë qejf urdhnoi e e bëni shkresën, e vërtetoi

me dorën e vet, ia dha katundares edhe i uroi udhën e mbarë.

Tani ushtarët e 'tij t' armatosun me kosa u-derdhën nëpër ushtarët serbë e bullgarë e, tue ua shkurtue kambët, i shtrijshin për dhé gallë e për serr. Kështu Sulltani e fitoi luftën, tue përdorë kosat. Kjo luftë e çuditëshme, u-quejt „ **Lufta e kosavet** „ dhe prej **Kosës**, qi hyni në punë në kët luftë, i gjithë vilajeti, u-quejt Kosovë.

Si e fitoi luftën Sulltan Mehmeti, thërret princ Doçi e Lurës në çadrën e 'tij dhe i falet nderit për shërbimet, qi i kishte bërë kundër bullgarvet; së fundi si është zakoni i mbretënvët, i thotë të kërkojë një dhuratë. Princ Doçi dhuratën qi do të kërkonte, e kishte mendue ç' më përpara dhe i thotë : dhurata, qi unë do të të kërkoj, është ajo, e cila më shtiu në luftë kundër bullgarvet dhe më bëni qi unë të mbaj anën t' ande në kët luftë. Sikur të më jepni fushën e Dibrës, unë do të jem tepër i lumtun. Bullgarët do t'i përzà q'andej dhe gjithë popullsin e principatës t' ime kam me e vendosë në fushën e gjanë të Dibrës „.

Sulltani jo vetëm i dha lëje të pushtojë Dibrën dhe të përzajë bullgarët prej andej, por i dha edhe ndihmë, qi ta mbushi dëshirën e 'tij sa më shpejt. Bullgarët dibranë të përzananun shkuen e ngrefën qytetin „ Deberta „, qi don me thanë Dibranët, sot katundi „ Debretsh „, pesëmbëdhjetë km. në veri t' Ohrit.

Princ Doçi e shpërnguli pra të gjithë popullsin e 'tij në Dibër : popullsin e Oroshit e vendosi në qytetin e Dibrës, ku ngrefi edhe kryevendin e 'tij; popullsin e katundevet malësore të Mirditës e vendosi nëpër katundet fushore të Dibrës; kështu del pra se Dibranët e sotshëm janë Mirditasit e vjetër.

Më vonë Princ Doçi, për me fitue simpathin e Sulltanit, ndërroi edhe fën e 'tij medje u-quejt „ Hoxhë Doçi „. Principata e 'tij ishte fare e lirë dhe, përveç një harraçi të vogël, nuk pat pague kurrgjà t' jetër. Kët të drejtë e patën gëzue Dibranët edhe mbas Hoxhë Doçit. Kët e kuptojmë nga disa gojdhana të tjera' qi tregojnë se Sulltani pat dërgue në Dibër shpesh herë pashallarë për me mbledhë të dheta e me marrë ushtarë.

Trashëgimtari i Hoxhë Doçit u-quejtë „ Hoxhë Oglli „ qi d. m. th. „ Biri i Hoxhës „. Kështu u-bà dera e Hoxhollit, qi sundoi në Dibër, deri sa Turqija pat nën sundim vendin t' onë, Kjo derë sot ka një histori të tanë në gojë të popullit të Dibrës, por sot prej 'saj nuk ka mashkull.

Mbledhë prej

M. Shehut '32.

Shënim : Kjo gojdhane është e errët vetëm për sa i përket punës së Hoxhollit në kohën e Moisi Golemit.

Folklore-a**Kënga e Abdul Frashërit.**

Kurvelesh e Gegëri
 U mbëlodhë nd' Ergjери
 Tek Abdul Bej Frashëri
 Për të bërë Shqipëri
 U përpoq i varfëri
 Shtatë herë në Fërngji
 Prishi një barrë flori
 U përpoqe bej për në
 Po ta panë me hilë.

Kënga e Ismail Qemalit.

O shokë ç' më mori malli
 Ku është Ismail Qemali
 Në Paris brënda te Krali
 Shtrijtur si sorkadh mali
 Thotë Shqipen mos ma ndani
 E do po s' ja lë Junani
 Dhe Esat pashë rrujani
 Esat pasha faqe-zi
 Pse s' e do për Shqipëri
 A të plastë njeri sy.

Mbledhur prej

M. Ahmetit '31.

Kanga e fyellit.

M' varën Tane, m' var' n tani! Qen kërbicin se ç' e vranë!
 Thuej t' yt et e le t' na vi! M' varën Tane, m' var' n tani!
 M' varën Tane, m' var' n tani! Dash oqiçin n' hellt ç' e kanë!
 Ranë një palë hajdutë n' bakti! M' varën Tane, m' var' n tani!
 M' varën Tane, m' var' n tani! Mue n' maj' t manit se ç' më kanë!
 Thuej t' yt e le t' na vi! M' varën Tane, m' var' n tani!

Shënim : Taneja, një gocë shumë e zgjuet dhe e hijeshme, ishte e bij' e njëj katundari të pasun. I ati, mbassi kishte shumë dhen, merr një bari, i cili ishte i hijeshëm dhe i zgjuet, thuej sa Taneja. Dy të rijt vunë dashuni por nuk çfaqeshin, se kishin frikë t' jatin e Tanes. Me që zjarri i

dashnis po ua diqte zemrat, po mundoheshin të gjejnë mënyrën, për me e shfrye dufin. Djali e gjeti mjetin, e ky mjet qe fyelli, të cilin ia tregoi dhe Tanes. Kjo i nxu melodit e ndryshme, që kishin kuptime të veçanta. Tashti djali çdo ndjenjë të zemrës së 'tij ase çdo nevojë i tregonte me anë melodishë, të cilat, veç atyne dy zemrave të zhuritme, s'i merrte vesh kërkush. Nji natë ranë nji palë kusarë në stan. Këta, si vranë qen kërbicin (qenin e zi), hynë në stan, zënë barin, të cilin e lidhën këmbë-e-duer dhe therën dashin ogiç Bariu, që të shpëtojë vehten dhe gjân e të zot, i u-lut kusarve që t' i jepnin leje të hypte në nji mand, që ishte n' oborr, e t' i bjerë fyellit. Kusarët, e quejtën për hiç gjâ këte kërkesë, e zgjidhën dhe e lanë të hypi në mând e t' i bjerë fyellit. Bariu, aty, mori nji melodi, e cila numronte fjalët, që shënohen në këte kangë. Taneja e ndëgjoji e e kuptoi fyellin dhe, shkoi të zgjojë t' jatn Ky nuk deshi t' u besonte fjalëvet të së bijës, por ajo e bindi. Atëhere ngrihet, armatoset, del jasht dhe si mbledh disa shokë trima, shkon drejt për në stan, kur mbas nji përpjekjeje qi u-bâ, u-vranë të gjithë kusarët. Këtu u-muer vesht edhe dashunia e dy të rijvet. Barijt e Shpatit (krahinë në Jugë t' Elbasanit) e kanë për nderë të dinë melodinë e kësajë kange edhe cucat mburren, kur i venë pas fyellit, tue i këndue fjalët.

Mbledhë në krahinë

e Shpatit t' Elbasanit.

P. Elezi '24.

Fjalë të vjetra.

Mos e mbaj thesin e huej mbi kokë.

Ujku mjegull do.

Nji copë mish me dy sy.

Shejtani flê, pse e zgjon ?

Mblidhuni o të marrë hani gjënë e të urtit.

S' mbâhet shtëpija me nji trá.

S' mbahet stani me ljepura.

Kokë e falur s' purret.

Mos pështy përpjetë se të bije fëtyrës.

Tesha rëndon nga të rëndit.

S' del dhijamë nga pleshti.

Zoqt, kur hapin krahat, i largohen folesë.

Të dhëmp dhëmballa atje vete gjuha.

Djelmt hanë kumbëlla, pleqve u mpihen dhëmballët.

I ka mbledhur

S. Cerga '31.

Për t' -u çlodhë.**I hutuari.**

Kur vajti një herë të hante darkë në restaurant Frederiku, që hutohej shpejt, i vjen pranë një shakaxhi e i thotë ?

— Si vete ?

— Kush, pyeti Frederiku.

— Gruaja jote, sepse isha sot në mëngjes në katundin t'uaj edhe mësova nga fqinjët, se ajo paska rënë nga shkallët edhe paska thyer këmbën, prandaj po ju pyes si është,

— Ej ta marrë dreqi këtë punë, nukë dinja asgjë

— Shko shpejt ta marrish vesht. !

Frederiku niset me të shpejtë. N' ate kohë, kur po hypte në automobil, goditi kryet në derën e tij dhe tha :

— Dreq ! o punë ! ç' pësova kështu ! unë s' jam i martuar !

— Ati me dy të bijt —

Një at kishte dy djem. Një ditë vere, tek po rinin, i thotë i ati djalit më të math : — “ Bir-o ngreu e më sjell pakë ujë të pi „.

Djali i vogël, kur pa se i madhi po përtypej, i thotë t' et :

— Baba, pa ngreu pi vetë e mos urdhëro atë budalla, pastaj më sjell edhe mua pak se kam etje.

Problema :**Sofizmë.**

Ishte kohë dreke, kur një zotni, i ulur pranë praktikës së një gjellëtoreje, dëgjon këto fjalë t' ashpëra : „ I çmendur ! ç' kërkon ti këtu pranë praktikës s' ime ? Ta kam për të ndrequr qejfin në gjyq. “ — “ Në gjyq ? E pse, ç' të bëra, a mos të hëngra nonjë copë portë ? — “ Jo, iu-përgjegj gjellëtori, portën s' ma hëngre po, ke gjysmë ore, që po ngope me erën e gjellëvet të mija „ — Ç' thua kështu i tha zotnia, më s' është dëgjuar një e tillë punë, që t' i kërkohen të holla njeriut pse ka marrë erën e gjellëvet ! Nuk shkuan shumë ditë, kur zotnin t'onë na e thërrasin në gjyq për punën që thamë.

Kush edhe si mundet ta shpëtojë këtë zotni të pafajshëm pa kurrë farë dënimi duke ditur se gjyqi do t' a denojë, në qoftë se nuk e paguan të zotin e gjelltores.

Problemë.

Nji gocë e nji çun kishin qenë miq në nji katund e po këtheheshin në shtëpi. Rrugës, tue kalue nëpër mes të aravet, panë nji bujk, qi po punonte, edhe i thanë të dy me nji gojë "pun' e mbarë „. Bujku u përgjegjet : „ Mbarë paç-i edhe rrug' e mbarë u qoftë vlla e motër „. " Jo, iu përgjegj çuni, ne nuk jemi vlla e motër; motrën e kësaj unë e kam motër dhe këtë e kam gruë „. Bujku, u çudit, dhe shkoi e pyeti p'akun e katundit. Si do t' i jetë përgjegjë plaku ?

Lajme të Shkollës.

Festa e mbyljes së Shkollavet

Më 10 të Majit 1931 u-bà festa për mbarimin e vitit shkolluer. Në fushën e sportit qenë gjithë shkollat fillore, paraushtarakët dhe Shkolla Normale. Shkollat fillore bënë veç e veç lojna të ndryshme gjimnastike, po ashtu edhe paraushtarakët bënë stërvitje gjimnastike me armë e pa armë. Shkolla Normale bëni tri piramide të bukura edhe luejti dy valle suedeze të m. r. Shkolla Ushtrimore e Normales bëni disa lojna të bukura edhe dy piramide.

Në foot-ball.

Më 3 të Majit 1931 Cara D. '31, beku më i mirë i Elbasanit u-vra shumë rëndë në ndeshjen e foot-ballit, për kampionatin, qi u-bà me sport klubin Teuta në Durrës. Mbas nji jave mjekimi në Tiranë, u-këthye i shëndoshë në shkollë.

Kampionati i foot-balli-t.

Qysh prej 15 të Majit 1931 filloi në shkollën t' onë kampionati i foot-ball-it ndërmjet rendeve edhe mbajti gjer më 18 të Qershorit. Përfundimi është ky :

Rendi fitues	Rendi humbës	Goalët	Pikat
'32	'35	3:0	2
'33	'35	7:0	2
'33 — '34	—	0:0	1 — 1
'32	'33	2:1	2
'34	'32	4:0	2
'34	'35	2:0	2

Rendi '34 fitoi me 5 pika kampionatin e foot-ball-it të Shkollës Normale për vitin 1930-1931. Si çmim ka marrë flamurin e kampionatit të shkollës në foot-ball, qi është caktue për këtë gjë. Këtë flamur do t' a mbajë, deri kur të bëhen ndeshjet e kampionatit të foot-ball-it për vitin 1931-1932.

Rendi '31 i. cili e pat fitue kampionatin më 1928-1929, nuk i hyni kësajë pune sivjet, sepse po përgatitesh për me i dalë në krye maturës, kështu qi kësajë here u-ndeshën vetëm rendi i I-rë, i II-të, i III-të e i IV-ti.

Shëtitje.

Më 25 të Majit 1931 rendi '32 dhe '33 shkuen me profesorin e Historis së Natyrës, Z. I. Haxhihysenin, për me pa shpellën e Letanit.

Gjithashtu më 3 të Qershorit rendi '32 shkoi në Llixhë me profesorin kujdestar të rendit, Z. T. Tela. Këtu panë me kujdes banjat edhe burimet e 'tyne edhe nxuerrën mjaft fytyra për kujtim.

Mbyllja e Shkollës.

Më 20 të Qershorit 1931 u-mbaruen mësimet e u-mbyll Shkolla. Ate mbramje nëndrejtori, Z. V. Andoni, u foli nxënësve n' internat për " Fundin e vitit Shkolluer „.

Z. Andoni zû me gojë përparimet, qi ka bënë shkolla këte mot: Çfaqjet dramatike e muzike të ç' do rendi n' Elbasan e gjetiu e përparimin e shoqiviet të rendvet, të botuemit përsëri të Normalistit, edhe i këshilloi nxënësit qi gjithë këta përparime e të mira, qi kanë pamun e kanë ndigjuem këtu në shkollë t' i marrin me vehte nëpër vendet e 'tyne edhe t' i fusin në punë. Mbasandaj foli për dashuninë, qi duhet të kenë nxënësit për shkollën e tyne. Duhet t' a dijnë vehten të lidhun se kanë dalë po prej asajë shkolle edhe t' a duen, t' a nderojnë e t' a mprojnë shkollën e tyne kudo e kurdo, sepse shkolla është nana e tyne e dashun. Alma Mater.

Edhe nji koncert.

Më 21 të Qershorit 1931, në mbramjet, rendi '33 luejti n' internat pak muzikë të bukur edhe na kënaqi.

Festa e lojave Athleticke.

Më 22 të Qershorit, mbas dreke, u-bënë në fushën e sportit lojat e athleticës së lehtë të shkollës s' onë.

Fusha ishte ndrequn për bukuri prej nxënësve ndën kqyr-

jen e profesorit të gjimnastikës, Z. P. Andonit. Gjithë zyrtarët e vendit dhe shum popull kishin ardhë të shofin.

Kryetar i paris së nderit qe Z. Prefekt edhe nënkryetar Z. Kryetar i Bashkis. Kryetar i paris së lojave qe zav. Drejtori i Normales, Z. A. Gashi edhe drejtues qe Z. P. Andoni; anëtarë të paris ishin mës nga personeli i shkollës edhe Normalistët, qi kanë mbarue Normalen. Rregullimin e fushës e patën nxënësit.

Në vrull 100 m. i pari duel Xhafa '34. Në hov së nalti i pari duel Sevo '33 me 1' 11 1/5". Në vrap 800 m. i pari duel Ruli '33 me 2' e 35". Në të hedhunit e topit të hekurit i pari duel Berisha '32 me 10 85 1/2 m. Në hov së gjati fitoi Sevo '33 me 577 m. Në vrap 400 m. çmimin e parë e muer Xhafa '34 me 1' 11 1/5". Në të hudhunit e diskut fitoi Berisha '32 me 25,05 m. Në tri hapa i pari duel Sevo '33 me 11,11 m. Në të hudhunit e shtizës Berisha '32 duel i pari me 35,40 m. Në vrap 1500 m. i pari duel Selenica A. '33 me 5' e 55 1/5". Në vrap me postat çmimin e parë e muer rendi '34, të dytin '33 dhe të tretin '32.

Mbassi mbaruen lojat, Prefekti, Z. Z. Kadarja, ua ndau çmimet fituesve t' atletikës. Flamurin e kampionatit të shkollës për atletikën e fitoi rendi '33 me 40 pikë, i dyti qe rendi '34 me 33 pikë; i treti '32 me 29 pikë. Si përhera, edhe këte ditë i u-qëllue punës fare mirë e u-dëfitye edhe një herë se shkolla e jonë zë një vend të parë nder institutet e mesme të Shqipnisë. Normalistët le të mburren për shkollën e tyne.

Çfaqja dramatike e Shkollës Ushtrimore.

Më 22 të Qershorit 1931 Shkolla Ushtrimore e Normales çfaqti në cinema theatër "Beethoven", përrallën e dramatizue me "B a r d h o s h j a".

Sqena ishte ndrequn për bukuri. Amatorët e vegjël kanë luejtun aqë bukur sa nuk shpresohesh. Mbreti (Hoxha S.) ka luejtun shumë bukur pjesën e vet. Mbretnesha e keqe (Palluqi R.) përfaqësonte me të vërtetë një grue grindavece dhe cmirzezë. Princesha (Josifi Donika) duhet lëvdue me të drejtë se na ka dalë përpara si një princeshë e vërtetë, e paisun me të gjitha cilësit; veshja e bukur, pamja simpathike, e folmja me vend edhe me lëvizjet e duhuna, qi ka pasun kjo vashë e vogël, na ka lanë vrugën më të bukur. Me thënë të drejtën, as një rol gruaje nuk kemi shijue n'as një çfaqje, si rolin e bukur të kësaj princeshe. Edhe të tjerët kanë luejtun shumë bukur e të

gjithë u-kënaqën, çfaqja u-bà edhe dy herë të tjerë.

Kjo çfaqje u ka lanë mbresë të madhe popullit, të cilët mbetën të habitun, kur shifshin se sa bukur luejshin të vegjlit t'onë.

Shpresojmë të merret si shembullë kjo punë e Normales, kështu qi edhe fëmijtë t'onë të kenë kësi zbavitjesh mendore e të frytshme, të cilat u a zhvillojnë edhe zotësitë qi kanë.

Provimet e Maturës.

Më 7 të Qershorit urdhën këtu Z. L. Shala, i dërguem nga Ministrija e Arsimit për me u-gjindun në provimet e maturës.

Provimet praktike të maturës filluen më 9 të Qershorit edhe mbaruen më 12. Pushimet e maturës, për me u-bâmë gati për provimet me gojë, filluen më 13 të Qershorit.

Provimet e maturës në lândët e para filluen më 22 dhe mbaruen më 28 të Qershorit. Më 30 u-përndanë diftesat e maturitetit.

Këte mot provimet e maturës u-banë në Provë praktike, Pedagogji, Gjuhë e Matematikë.

Me rendin '31 muer dëftesë maturiteti edhe A Tenhai '29.

Posta e jonë.

Z. R Spahiut, Honesh — Pajtimin e katër vetëvet e muarmë. ju falemi nderit. Sa mundemi po përpiqemi të kemi rregullë, përpikni e vullnet, mirpo ç' të bëjmë ne kurse deri tani s' na kanë ardhur të gjitha listat ?

Z. R. Sulejmanit, Durrës — Listën edhe pajtimet e nijzet e tre vetëvet i muarmë. Ju falemi nderit për së tepërmi Do t' ishte mirë sikur t' ju kishin shembëll edhe të tjerët.

Z. H. Reçit Tiranë — Listën e muarmë. Trembëdhjetë copët e numrit të parë ju a dërguam për shkollën e Oficerëvet të plotësimit. Ju falemi nderit për përkrahjet. Normalisti gjithmonë pret prej jush.

ZZ B. Zhudit, Pogradec; El. Shtëpanit, Shëngjergj; I. Kolçit, Kukës — Listat i muarmë e ju falemi nderit për fjalët e mira.

Z. H. Muçës, Krumë — Listën si edhe pajtimin e tre vetëvet i muarmë. Ju falemi nderit,

Lutje.

Me këte bâhen katër numra të Normalistit; prandaj i lutemi Z. Z. pajtimtarëvet, të na çojnë pajtimet, sepse kemi për t' i dhanë shtypshkronjës mâ se 300 fr. ari.

Editori.

gjithë u-kënaqën, çfaqja u-bâ edhe dy herë të tjerë.

Kjo çfaqje u ka lanë mbresë të madhe popullit, të cilët mbetën të habitun, kur shifshin se sa bukur luejshin të vegjlit t'onë.

Shpresojmë të merret si shembullë kjo punë e Normales, kështu qi edhe fëmijët t'onë të kenë kësi zbavitjesh mendore e të frytshme, të cilat u a zhvillojnë edhe zotësitë qi kanë.

Provimet e Maturës.

Më 7 të Qershorit urdhën këtu Z. L. Shala, i dërguem nga Ministrija e Arsimit për me u-gjindun në provimet e maturës.

Provimet praktike të maturës filluen më 9 të Qershorit edhe mbaruen më 12. Pushimet e maturës, për me u-bâmë gati për provimet me gojë, filluen më 13 të Qershorit.

Provimet e maturës në lëndët e para filluen më 22 dhe mbaruen më 28 të Qershorit. Më 30 u-përndanë diftesat e maturitetit.

Këte mot provimet e maturës u-bânë në Provë praktike, Pedagogji, Gjuhë e Matematikë.

Me rendin '31 muer dëftesë maturiteti edhe A Tenhai '29.

Posta e jonë.

Z. R Spahiut, Honesh — Pajtimin e katër vetëvet e muarmë. ju falemi nderit. Sa mundemi po përpiqemi të kemi rregullë, përpikni e vullnet, mirpo ç' të bëjmë ne kurse deri tani s' na kanë ardhur të gjitha listat ?

Z. R. Sulejmanit, Durrës — Listën edhe pajtimet e nijzet e tre vetëvet i muarmë. Ju falemi nderit për së tepërmi Do t' ishte mirë sikur t' ju kishin shembëll edhe të tjerët.

Z. H. Reçit Tiranë — Listën e muarmë. Trembëdhjetë copët e numrit të parë ju a dërguam për shkollën e Oficerëvet të plotësimit. Ju falemi nderit për përkrahjet. Normalisti gjithmonë pret prej jush.

ZZ B. Zhudit, Pogradec; El. Shtëpanit, Shëngjergj; I. Kolçit, Kukës — Listat i muarmë e ju falemi nderit për fjalët e mira.

Z. H. Muçës, Krumë — Listën si edhe pajtimin e tre vetëvet i muarmë. Ju falemi nderit,

Lutje.

Me këte bâhen katër numra të Normalistit; prandaj i lutemi Z. Z. pajtimtarëvet, të na çojnë pajtimet, sepse kemi për t'i dhanë shtypshkronjës mâ se 300 fr. ari.

Editori.

Muzeu i Shkollës Normale